

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

NATO, Bllaca, KOSOVA

*(Aktivitete me rastin e 20-vjetorit të intervenimit
të NATO-s në Kosovë dhe eksodin e Bllacës)*

25



Shkup, 2019

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 25 – 2019
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof.dr. Skender ASANI

Kryeredaktor:
Prof.dr. Sevdail DEMIRI

Këshilli redaktues:
Prof.dr. Skender ASANI
Prof.dr. Sefer TAHIRI
Doc.dr. Minir ADEMI
PhD.cand. Valdeta KASAPI
PhD.cand. Besnik RAMETI

Sekretar i redaksisë:
Dr.sc. Murtezan IDRIZI

Copyright©ITSHKSH, 2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4653–95–0
www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Kulturës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

NATO, Bllaca, KOSOVA

*(Aktivitete me rastin e 20-vjetorit të intervenimit
të NATO-s në Kosovë dhe eksodin e Bllacës)*

25

SCUPI

Shkup, 2019

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE.....	7
Skender ASANI: PROCESË POZITIVE ZOR SE DO TË MUND TË NDODHNIN, PA INTERVENIMIN ENERGJIK TË NATO–s 20 VJET MË PARË.....	11
Sabit SYLA: BOMBARDIMET E NATO–s!	14
Agon DEMJAJA: INTERVENIMI I NATO–S NË KOSOVË: 20 VJET PAS.....	19
Enver HOXHAI: QË NGA VITI 1999, EDHE HISTORIA ËSHTE NË ANËN TONË.....	33
Ali AHMETI: LIRINË E FITUAM ME GJAKUN TONË, POR ÇLIRIMIN ME NATO–n.....	37
BLLACA, HOLOKAUSTI SHQIPTAR	43
Jahja LLUKA: ZHVILLIMET NË KOSOVË, PAS INSTALIMIT TË REGJIMIT TË DHUNSHËM TË MILLOSHEVIQIT, DERI TE GJENOCIDI NË BLLACË	46
Sait SAITI: PËRGJIGJJA HUMANITARE E KRYQIT TË KUQ GJATË KRIZËS KOSOVARE.....	53
Zeqirija IBRAHIMI: NË KUFIRIN E JETËS	70
NË SHKUP U PROMOVUA LIBRI: “BLLACA, DHIMBJA E LIRISË” – EMIN AZEMI	77
Sevdail DEMIRI: NJË VEPËR PËR BLLACËN ‘99, ARGUMENT PËR EKSODIN DHE SPASTRIMIN ETNIK TË KOSOVËS.....	79
DY PROJEKTET TEMATIKE PËR BLLACËN, U PROMOVUAN NË PRISHTINË.....	83

HYRJE

Viti 2019 u karakterizua me aktivitete dhe manifestime të shumta anembanë trojeve shqiptare, në kujtim të 20-vjetorit të luftës çlirimtare në Kosovë dhe çlirimin nga Serbia pushtuese. Një pjesë e këtyre aktiviteteve u zhvilluan edhe në Shkup, ku një nga institucionet kryesore bartëse ishte edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.

Kështu, Instituti jonë pati nderin që më 24 mars 2019 të shënojë përvjetorin e 20-të të intervenimit të forcave ushtarake të NATO-s ndaj qaceve serbe, për të parandaluar spastrimin etnik të Kosovës nga etnosi shqiptar. Mbase, ishte ky manifestimi kryesor në mbarë hapësirën shqiptare, ku në mënyrë madhështore, u përkujtua kjo datë, me fjalime dhe referate shkencore, të cilat botohen të plota në vijim të këtij numri të edicionit “Scupi”.

Më tej, Instituti jonë ishte një nga bartësit kryesor të idesë për themelimin e një qendre përkujtimore për eksodin e madh që kishte ndodhur 20 vjet më parë. Në Bllacë, në kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë, asokohe kryqëzoheshin fatet e qindra-mijëra shpirtrave të pafajshëm që po largoheshin dhunshëm nga vatrat stërgjyshore. Ajo ngjarje meritonte një përkushtim më serioz që të mbetej përgjithmonë në memorien shqiptare, si një storje që nuk duhej humbur kurrë. Prandaj, në këtë vëllim të “Scupi”-t i kemi botuar materialet edhe nga tribuna shkencore që e kemi organizuar përkittazi me këtë ngjarje, ku persona eminent flasin për planet fatkeqe serbe, krizën e madhe humanitare dhe përballjen me të me shumë sakrifica e mundime.

Në këtë vijë, Instituti jonë botoi dhe promovoi në Shkup dhe Prishtinë, edhe librin e publicistit Emin Azemi, me temë “Bllaca – dhimbja e lirisë”, që gjithashtu i kushtohet tragjedisë shqiptare të Bllacës. Prandaj, një pjesë e materialeve nga aktivitetet e zhvilluara promovuese, janë botuar poshtu në këtë vëllim tematik të “Scupi”-t.

Dhe në pjesën e fundit, e kemi botuar të plotë edhe elaboratin për Qendrën Përkujtimore të Gjenocidit “Bllacë 1999”, si një përkujtim permanent ndaj institucioneve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, që ky projekt i përbashkët mes dy shtetesh sa më parë të funksionalizohet dhe ta merr formën e dëshiruar në të dyja anët e kufirit.

Në këtë mënyrë rrumbullakohet edhe i gjithë qëllimi i botimit të numrit 25 të edicionit “Scupi”, me titullin simbolik dhe tematik: “NATO, Bllaca, KOSOVA”. Shpresojmë se sadopak kemi arritur që të lëmë një gjurmë të nevojshme në këtë përvjetor të rëndësishëm të historisë sonë më të re.

Redaksia

*I.**AKADEMI SOLEMNE**20–VJETORI I INTERVENIMIT TË
NATO–S NË KOSOVË**SHKUP, 24.03.2019*



*Paneli dhe sala e mbushur në shënimin e 20-vjetorit të
intervenimit të NATO-s mbi çaqet serbe*



DR. SKENDER ASANI

Drejtor i ITSHKSH–Shkup

PROCESE POZITIVE ZOR SE DO TË MUND TË NDODHNIN, PA INTERVENIMIN ENERGJIK TË NATO–S 20 VJET MË PARË

Të nderuara zonja dhe të nderuar zotërinj,

Fati i kombit tonë ka kaluar nëpër ngjarje të vrullshme historike, shpeshherë i shkelur dhe i nëpërkëmbur nga armiqtë e lirisë dhe demokracisë!

Ne, para se vijmë te 24 marsi i vitit 1999, ia vlen të kujtojmë edhe disa ngjarje kryesore në retrospektivë, të cilat lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë.

Në shekullin e XIX lindën projekte të mëdha hegjemoniste në Ballkan, të cilat u zyrtarizuan në konferencat e Londrës e Versajës, dhe u eliminuan pikërisht në 24 marsin e vitit 1999.

Në dekadat e para të shekullit XIX, Serbia, Greqia, e më vonë edhe Bullgaria, e fituan pavarësinë e tyre, dhe menjëherë i shprehën tendencat ekspansioniste nëpërmjet projekteve famëkeqe, siç ishin: Serbia e Madhe, Greqia e Madhe, Bullgaria e Madhe. Rusia ishte tutorja kryesore e këtyre nxitjeve, në kurriz të popujve më të vegjël.

Projekti rus u realizua me Aleancën Ballkanike. Me betejën e Kumanovës të tetorit 1912, iu dha goditja përfundimtare Perandorisë Osmane, dhe me këtë rast u krijuan Serbia e Madhe dhe Greqia e Madhe. Konferenca e Ambasadorëve në Londër i vërtetoi gjendjet faktike në teren, ndërsa Evropa në atë kohë nuk ishte e gatshme për

një luftë botërore gjithëpërfshirëse. Në Konferencën e Londrës, me insistimin e Austro–Hungarisë, u krijua shteti shqiptar i gjymtuar.

Në Konferencën e Versajës dominuan dy koncepte kryesore: njëri koncept ishte ai koalicionit të Antantës, të cilët ishin fitues e Luftës së Parë Botërore, dhe kërkonin territore nga shkatërrimi i Perandorisë Osmane dhe asaj Austro–Hungareze. Ndërsa, koncepti i dytë ishte ai i presidentit amerikan Vudro Vilson, i cili i proklamoi 14 kërkesat e njohura, që u mundësonin edhe popujve të vegjël të drejtën për vetëvendosje. Nga ky koncept i presidentit amerikan, si garancë që të fitohet kjo e drejtë, gjatë procesit u themelua Shoqata e Kombeve në Gjenevë, dhe më vonë Organizata e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Më vonë, gjatë akteve të shtetndërtimit, shumë shtete u bazuan në konceptin e Vilsonit, me çka këtë të drejtë e fitoi Shqipëria, Maqedonia, dhe në fundshekullin e XX, edhe Kosova.

Gjatë intervenimit të Aleancës Veriatlantike – NATO, kundër Serbisë, në vitin 1999, si argument kryesor u morë kriza humanitare, por në esencë, në mënyrë të natyrshme ishte vazhdimësia e konceptit të presidentit Vilson për popujt e vegjël. Kjo për faktin se nga projekti i shekullit XIX, që e realizonte Serbia, e kishte ngulfatur vullnetin e popujve tjerë të Ballkanit që ta ushtrojnë këtë të drejtë të natyrshme. Dhe, vetëm pas intervenimit të NATO–s dhe kapitullimit të Serbisë, popujt ballkanik filluan të frymojnë lirshëm dhe të krijojnë shtetet e tyre të pavarura.

Mali i Zi e fitoi pavarësinë e plotë dhe u anëtarësua në NATO; Kroacia u anëtarësua në NATO dhe BE; Shqipëria u anëtarësua në NATO; Kosova shpalli shtetin e pavarur, me perspektivë të qartë drejt NATO–s dhe BE–së; Republika e Maqedonisë, tanimë e Veriut, me ndryshimet e fundit kushtetuese, përfundimisht po

bëhet gati të jetë anëtarja e re e NATO-s. Me këtë rreshtim të qartë të shteteve ballkanike në krahun e Aleancës më të madhe ushtarake-politike perëndimore, po krijohet një klimë e re e perspektivës tonë të përbashkët evropiane.

Të gjitha këto procese pozitive të kohës më të re në Ballkan, zor se do të mund të ndodhnin, pa intervenimin e sigurt dhe energjik të NATO-s, 20 vjet më parë, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por, sot kur e kujtojmë këtë datë të rëndësishme për ardhmërinë tonë, kujtojmë edhe kontributin dhe sakrificën e mijëra veprimtarëve, luftëtarëve, dëshmorëve e martirëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët me rezistencën e tyre aktive, e nxitën 24 marsin dhe të gjitha ndryshimet pozitive që ndodhën në këto treva.

Ju faleminderit shumë!

DR. SABIT SYLA

Drejtor i Institutit të Historisë – Prishtinë

BOMBARDIMET E NATO-s!

Në vitet 90-të të shekullit XX-të, lufta çlirimtare e cila pati si pikë reference çlirimin kombëtar, u bë gjenerues i problemeve që ndikuan thellësisht në diplomacinë preventive të SHBA-së e Fuqive Evropiane. Pra, ndryshimi rrënjësor i kontekstit të brendshëm të zhvillimeve ka sjellë ndryshim fundamental të jashtëm, si dhe qasje të re të diplomacisë së shteteve kryesore perëndimore. Fillimisht, Kosova kishte një vëmendje sipërfaqësore, nuk ishte fare pjesë e një procesi ndërkombëtar. Kjo u dëshmuar në dy konferenca ndërkombëtare, e para ishte Konferenca e Londrës, mbajtur në gusht 1992, dhe e dyta ishte Dayton-i.

Lufta e armatosur u shfaq si një aktor i ri në skenë, Kosova u shndërrua në një problem mbarëkombëtar dhe u vu, si asnjëherë tjetër në historinë kombëtare të shqiptarëve, në fokusin e vëmendjes botërore. Për vendet anëtare të NATO-s dhe të Grupit të Kontaktit, çështja e Kosovës në fillimin e krizës ishte një problem që duhej zgjidhur me mjete diplomatike, pa përdorur forcën, me qëllim që Kosovës t'i rikthehej autonomia e anuluar nga Serbia. Politika amerikane fillimisht ishte ndërtuar mbi supozimin se agjenda e UÇK-së për pavarësi kombëtare ishte e papranueshme, ndërsa shtypja serbe disproporcionale. Por, politika amerikane do të ndryshonte pas marsit të vitit 1998, menjëherë pas betejës dhe masakrës së policisë serbe mbi familjen Jashari dhe vrasjes në Drenicë të shume njerëzve të pafajshëm. Madelene Albright pas kësaj ngjarje emëroi Richard Holbrooke si të dërguarin e saj të posaçëm të

qeverisë amerikane në Kosovë. Holbrooke shkoi në Beograd dhe i kërkoi Milosheviçit me ngulm që të ndërpriste aktet e dhunës ndaj popullsisë civile në Kosovë, por ndeshi në refuzimin e tij. Të pafrytshme ishin edhe përpjekjet e ambasadorit William Walker pranë Milosheviçit për të ndalur dhunën.

Forcat e NATO-s për herë të parë u përfshinë në një aksion të madh ushtarak kundër një vendi tjetër, pa siguruar më parë miratimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por kjo ishte e pamundur për shkak të sinjaleve të qarta kundërshtuese të dy prej anëtarëve të përhershëm të tij – Ruisë dhe Kinës, të cilat do të vendosnin veton, nëse ky version do të votohej në Këshillin e Sigurimit [KS]. Rusia dhe Kina e kundërshtuan fort metodën e ndërhyrjes së armatosur të NATO-s pa miratimin e KS, duke e quajtur veprimin e saj si shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare.

Përpara ndërhyrjes ajrore të NATO-s ekzistonin diferenca e lëkundje edhe brenda shteteve përbërëse të saj. Jo të gjitha vendet anëtare mendonin se rruga më e mirë ishte ndërhyrja ushtarake e forcave të saj mbi Jugosllavinë e mbetur. Vende të tilla evropiane, si Franca, Gjermania e Italia prireshin drejt rrugës diplomatike të zgjidhjes së krizës, ndërsa SHBA dhe Britania e Madhe nuk e shihnin si oportune vazhdimin e mëtejshëm të dialogut me Millosheviçin. Por, refuzimi i Milosheviçit për të firmosur deklaratën e Konferencës së Rambujesë dhe shtimi i operacioneve policore në Kosovë i afroi qëndrimet e këtyre vendeve. Opsioni i ndërhyrjes ushtarake pas kësaj kohe, u konsiderua si e vetmja mënyrë për të zgjidhur krizën dhe për të shpëtuar popullin shqiptar të Kosovës nga spastrimi etnik. Në Gjermani, partitë në koalicion [Partia Socialdemokrate dhe Partia e Gjellbër] ndonëse me profil pacifist, u

pajtuari me versionin e ndërhyrjes së armatosur, me qëllim që të ndalonin dhunën dhe mizoritë e forcave serbe në Kosovë. Në Francë, forcat politike prireshin më shumë për një zgjidhje diplomatike se sa ushtarake. Qëndrim ekuivalent me të Francës mbante edhe Italia, ndërsa partitë e saj politike ishin të ndara në qëndrimet e tyre. Sidoqoftë, edhe qeveria u bashkua me aksionin e NATO-së. Ndërmjet të gjitha shteteve mbrojtja më e fortë e versionit të ndërhyrjes ushtarake në Kosovë erdhi nga Britania e Madhe. Kryeministri Toni Blair e gjykoi ndërhyrjen si një kauzë të drejtë, duke kërkuar përgjigje unike ndaj agresionit serb në Kosovë. Me këtë qëndrim u bashkuan edhe Shqipëria, Kroacia, Sllovenia e Turqia.

Pa dyshim, qëndrimi i SHBA-ve ishte më i rëndësishmi, për shkak të peshës së tyre brenda organizatës së Atlantikut të Veriut, brenda Grupit të Kontaktit, dhe në përgjithësi për shkak të forcës dhe autoritetit të tyre në arenën ndërkombëtare. Por, rrethet kritike në të dy anët e Atlantikut mendonin se, roli i Evropës në Ballkan duhej të ishte dominues në krahasin me atë të SHBA, dhe se vendet evropiane duhej të udhëhiqnin përpjekjet ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës në Kosovë. Me gjithë kritikën e shfaqura, ato nuk mundën të ndikojnë mbi politikën e jashtme të qeverisë amerikane. Sekretarja e Shtetit Amerikan, Madeline Albright, u përpoq të largonte ngurrimin e vendeve perëndimore, duke sjellë në vëmendje katastrofën e ndodhur vite më parë në Bosnjë. Ajo foli për sigurimin kolektiv, si mjetin më efikas për të ndaluar përhapjen e krizave. Administrata e Klintonit nxiti në mënyrë konstante ‘sigurinë kolektive’, për të justifikuar ndërhyrjen në Kosovë. Presidenti Klinton në disa raste u është referuar parimeve Willsoniane, si e drejta e vetëvendosjes. Gjenerali Wesley Clark – komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, në kujtimet e tij

fajëson Perëndimin, sepse nuk qe në gjendje të parandalonte katas-trofet e mëparshme, duke nënkuptuar sidomos ngjarjet në Bosnjë, në Ruanda, etj.

Përpara fillimit të operacioneve ajrore të NATO-s, trupat policore e paramilitare serbe kishin nisur fushatën e spastrimeve etnike në Kosovë. Ishin vrarë shume luftëtarë të UÇK-s dhe ishte ushtruar dhunë e ashpër mbi popullsinë civile. Masakra e Reçakut më 15 janar 1999, dhe masakrat tjera bënë ‘xhiron e botës’. Ato dëshmuuan për sjelljen barbare të forcave ushtarake serbe, dhe ushqyen idenë e pashmangshmërisë dhe të reagimit ushtarak të Perëndimit e SHBA. Legjitimiteti i ndërhyrjes së NATO-s ishte logjik dhe aksioni u mbështet dhe u justifikua mbi dy argumente bazike të lidhura me njëri-tjetrin, tek doktrina e ndërhyrjes humanitare dhe tek zbatimi i tre rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit për Serbinë, të cilat i kushtoheshin represionit serb në Kosovë. Në muajt mars, shtator dhe tetor 1998 Këshilli i Sigurimit kishte miratuar 3 rezoluta të posaçme për Kosovën.

Disa qeveri në Perëndim, e veçanërisht ajo gjermane, kishin të dhëna nga shërbimet e tyre të fshehta për planet sekrete serbe të spastrimeve etnike në Kosovë, të njohur me emrin e koduar “Plani Patkoi”. Ky plan dëshmon se spastrimi etnik në Kosovë nuk ishte një veprim i çastit, i diktuar nga ndërhyrja e NATO-s, por një aksion i paramenduar dhe i planifikuar nga shteti serb.

Me Konferencën e Rambujesë, Perëndimi konsumoi mjetet politike e diplomatike për arritjen e qëllimit, të cilat nuk u pranuan nga Millosheviçi, duke i hapur rrugën të vetmit mjet që mbetej—përdorimit të forcës, që do ta detyronin Millosheviçin të pranonte zgjidhjet e rekomanduara në tryezën e bisedimeve. Mosnjohja dhe mosfirmosja e deklaratës së Konferencës së Rambujesë nga delegacioni

serb, solli reagimin e fortë të Perëndimit, dhe si rrjedhojë sulmet ajrore të forcave të NATO-s mbi territorin e Kosovës e të Serbisë. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte akt i motivuar, pavarësisht nga rezervat e shprehura nga disa shtete. Dëshmia më e mirë e ndërhyrjes së saj është shteti i sotëm i lirë e i pavarur i Kosovës, si dhe stabiliteti i krijuar në rajonin tonë.

Ju faleminderit!

DR. AGON DEMJAJHA

Profesor në Universitetin e Tetovës

INTERVENIMI I NATO–s NË KOSOVË: 20 VJET PAS

1. Hyrje

Më 24 mars të këtij viti është shënuar 20 vjetori i fillimit të bombardimeve të NATO–s ndaj forcave ushtarako–policore serbe në Kosovë dhe Serbi. Në këtë ditë, para 20 vitesh Aleanca ushtarake më e fuqishme në botë vendosi të intervenonte për të mbrojtur popullatën civile të shqiptarëve në Kosovë nga terrori i hordhive ushtarake–policore dhe paramilitare të Millosheviqit. Ky intervenim i atëhershëm i NATO–s do të ketë pasoja të jashtëzakonshme për Kosovën në veçanti, por edhe për gjithë botën në përgjithësi. Falë bombardimeve të NATO–s, Kosova e fitoi lirinë, që pastaj më 17 shkurt 2008 u kurorëzua me pavarësinë e vendit. Kjo datë njëkohësisht shënon edhe fillimin e asaj që në Marrëdhëniet Ndërkombëtare njihet si ‘Intervenim Humanitar’ që nënkupton të drejtën e shteteve të ndërgjeshme demokratike për të ndërhyrë ndaj shteteve të cilat ushtrojnë terror dhe gjenocid ndaj popullatës civile të pambrojtur. Nga ky moment asnjë diktator apo regjim autoritar nuk do të guxonte që në mënyrë të egër t’i diskriminon dhe t’i shkel të drejtat e qytetrëve të vetë.

Pas këtij seksioni hyrës, në seksionin e ardhshëm, punimi do ta analizon më detajisht konfliktin në Kosovë gjatë viteve 1998–1999 dhe intervenimin e NATO–s në vitin 1999. Vëmendje e posaçme gjatë analizës do t’i kushtohet shkaqeve dhe arsyeve që sollën deri te ky intervenim, por edhe pasojave të tmerrshme që la pas ky

konflikt. Në sektionin e ardhshëm, pastaj do të trajtohen një varg mësimesh që dalin si rezultat i intervenimit të NATO-s, dhe atë si për Kosovën, ashtu edhe për rajonin dhe botën në tërësi. Në fund të punimit do të jipen konkluzionet kryesore që rrjedhin si rezultat i analizës së përgjithshme.

2. Konflikti në Kosovë dhe Intervenimi i NATO-s

Pas heqjes me dhunë të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe shpërbërjes së Jugosllavisë në vitin 1991, shqiptarët e Kosovës organizuan referendun dhe u deklaruan për pavarësi. Mirëpo, autoritetet serbe e injoruan këtë kërkesë legjitime të shqiptarëve në Kosovë dhe vazhduan ta mbanin nën kontroll Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë përmes forcave ushtarako-policore. Edhe pse studiues dhe vrojtues politikë të shumtë kishin paralajmëruar për përshkallëzimin e mundshëm të dhunës, bashkësia ndërkombëtare nuk kishte ndërmarr asnjë veprim konkret për të parandaluar një gjë të tillë. Si pasojë, nga shkurti i vitit 1998, në Kosovë filloi një konflikt i armatosur i një shkalle të gjerë mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave të policisë speciale dhe njësisve të rregullta të ushtrisë jugosllave.”¹

Gjatë periudhës shkurt 1998 – janar 1999, forcat ushtarako-policore dhe paramilitare të Serbisë kryen vrasjen e mijëra civilëve, dhunuan gratë shqiptare dhe shkatërruan pronat e qytetarëve. Si rezultat i këtyre ngjarjeve, erdhi deri te negociatat në Rambuje dhe intervenimi i NATO-s.” Bashkësia ndërkombëtare u vu në veprim sidomos pas masakrimit të familjes Jashari në Drenicë në vjeshtën e

¹ Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, “Interethnic Relations in the Western Balkans Implications for Kosovo.” Policy Paper No. 6/14, Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED), dhjetor 2014, f. 23.

vitit 1998 dhe masakrës së Reçakut në janar të vitit 1999. Rrjedhimisht, çështja e Kosovës e arrin shkallën më të lartë të ndërkombëtarizimit që si rezultat ka organizimin e Konferencës së Rambujesë. Në këtë konferencë ku merrnin pjesë delegacionet e shqiptarëve të Kosovës dhe ai i Serbisë, të dyja palëve ju dha një afat maksimal prej dy javësh për të arritur një kompromis.² Bazë e negociatave ishte plani 10–pikësh, i cili u garantonte shqiptarëve një “autonomi substanciale”, por që njëkohësisht e ruante integritetin territorial të Jugosllavisë së mbetur. Pas dështimit të arritjes së ndonjë marrëveshjeje në Konferencën e Rambujesë, dy javë më vonë më 18 mars 1999 në Pasis, delegacioni kosovar e nënshkroi marrëveshjen e Rambujes, ndërkaq që Serbia refuzoi ta bëj një gjë të tillë.

Si rezultat, me 24 mars 1999 filloi operacioni i forcave të NATO–s “Allied Force” kundër Jugosllavisë së mbetur që zgjati 78 ditë, deri me suspendimin e tyre me 10 qershor 1999. Duhet theksuar se rolin vendimtar për marrjen e vendimit për bombardimet e NATO–s e kishin SHBA–të dhe Britaninë e Madhe, sepse ishte angazhimi maksimal i Presidentit të atëhershëm Bill Clinton dhe ish–kryeministrit Tony Blair, që në rend të parë çuan deri te ky intervenim. Poashtu, SHBA–ja gjatë gjithë periudhës së bombardimeve e barti edhe barrën më të madhe ushtarake sepse shtete anëtare të Bashkimit Evropian kishin kontribuar vetëm 2% të forcave të tyre ushtarake në këtë operacion të NATO–s. Qëllimet e intervenimit ishin të qarta dhe to ishin bërë publike menjëherë pas fillimit të bombardimeve. NATO–ja kërkonte nga Milosheviqi së pari përfundimin e operacioneve luftarake në Kosovë, së dyti tërheqjen e të gjitha trupave ushtarake, policore dhe paraushtarake, së treti

² E Përmuajshme Mbarëkombëtare Politike, Ekonomike dhe Kulturore “SHENJA”, Nr.28, Gusht 2013, f. 32.

miratimin e pranimit të stacionimit të prezencës ushtarake ndër-kombëtare, së katërti rikthimin e pakusht të të gjithë të zhvendosurve dhe refugjatëve, si dhe hyrjen e papenguar të organizatave humanitare dhe së pesti pranimin e kornizës politike të bazave të Panit të Rambujesë. Në fillim të qershorit Milosheviqi pranoi një zgjidhje diplomatike dhe braktisi diskursin e tij të konfrontimit me Perëndimin. Janë bërë analiza të shumta se vallë operacionet ajrore kanë kontribuar që Milosheviqi të lëshonte, apo efekt vendimtar kishte marrja në konsideratë e opsionit të dërgimit të trupave tokësore ushtarake të NATO, që realisht të nënkuptonte edhe okupim ushtarak të Jugosllavisë së mbetur. Rrjedhimisht, më 10 qershor 1999, pas 78 ditësh të bombardimeve të NATO-s në caqet ushtarake serbe, u arrit “Marrëveshja teknike-ushtarake e Kumanovës”, në mes të përfaqësuesit të ushtrisë jugosllave dhe gjeneralit Xhekson.

“Nënshkrimi i Marrëveshjes tekniko-ushtarake midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s, shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe kapitullimin e Serbisë, me tërheqjen e forcave të saja nga territori i Kosovës. Ndërsa, pas hyrjes së forcave të NATO-s, në Kosovë, Këshilli i Sigurimit të OKB-së, më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244, me të cilën edhe formalisht vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së, e 10 qershorit 1999, duke u thirrur në zgjidhjen e gjendjes së rëndë humanitare në Kosovë, vendos Kosovën nën administrimin e OKB-së, për një afat të pacaktuar.”³ Megjithatë, pasojat e luftës ishin tragjike: të paktën 10,000 njerëz ishin vrarë,

³ Avdullah Robaj, “Demokracia parlamentare dhe shteti i së drejtës në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti Mbretëror “Iliria”, Prishtinë, 2007, f. 47.

rreth 800,000 ishin bërë refugjatë apo persona të zhvendosur, dhe pjesë të mëdha të vendit ishin shkatërruar.⁴ Nga ana tjetër, mandati i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) që synonte ta administronte Kosovën pa e paragjykuar statusin e saj të jashtëm ishte pothuaj i paprecedent sipas standardeve të operacioneve të KB në terren. Jo vetëm që ky u fuqizua ta merrte të tërë përgjegjësinë e plotë administrative të përkohshme mbi territorin e Kosovës, por këtij iu dha një rol qendror politik në zgjidhjen e konfliktit.⁵ Meqë bashkësia ndërkombëtare luftën e perceptoi si një konflikt etnik, “multiethniciteti” ishte njëri nga qëllimet kryesore të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Nga ana tjetër, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes forcat e NATO-s u futën në Kosovë me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve të Kosovës nga ndonjë hakmarrje të forcave serbe, por edhe për të siguruar përmbushjen e plotë të marrëveshjes. Njëzet vite pas, forca ushtarake të shteteve kryesore të NATO-s ende janë prezente në Kosovë në kuadër të KFOR-it për të garantuar sigurinë e kufijve të Kosovës.

3. Mësimet e Nxjerra nga Intevrenimi i NATO-s

Siç u theksua tanimë intervenimi ushtarak i NATO-s në vitin 1999 kishte pasoja të jashtëzakonshme për Kosovën në veçanti, por edhe për gjithë botën në përgjithësi. Si rezultat, sot trajtohen një varg

⁴ Marie-Janine Calic, “Kosovo in the twentieth century: A historical account,” në Ramesh Thakur dhe Albrecht Schnabel red., *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship*, United Nations University Press, Tokyo, dhjetor 2000, f. 19.

⁵ Yannis, Alexandros, “The UN as Government in Kosovo,” *Global Governance*, Nr. 10, 2004, f. 67.

mësimesh që dalin si rezultat i intervenimit të NATO-s, dhe ate si për Kosovën, ashtu edhe për rajonin dhe botën në tërësi. Falë bombardimeve të NATO-s, pas 10 vitesh okupim nga forcat policoro-ushtarake serbe, Kosova e fitoi lirinë. Nga na tjetër, u nevojiten edhe gati 10 vite që Kjo liri e fituar të shndërrohet në pavarësi. Më 26 mars 2007, pas më tepër se një viti të negociatave të pasuksesshme të sponsoruara nga Kombet e Bashkuara midis Serbisë dhe Kosovës për ta arritur një zgjidhje politike për statusin e Kosovës, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari e përgatiti Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Ndërkohë që e përsëriste që pavarësia ishte e vetmja mundësi e qëndrueshme, raporti e pranonte kapacitetin e kufizuar të Kosovës për ta siguruar mbrojtjen e minoriteteve, për të zhvilluar institucione të qëndrueshme demokratike, për ta rritur ekonominë, dhe për ta arritur pajtimin ndëretnik. Në pajtim me këtë, Ahtisaari propozonte që ushtrimi i pavarësisë së Kosovës dhe zbatimi i tipareve konkrete të Propozimit Gjithëpërfshirës të “mbikëqyrej dhe përkrahej” nga autoritetet ndërkombëtare civile dhe ushtarake. Ai kërkonte një autoritet ndërkombëtar “të fuqishëm” por “të përqendruar” lidhur me të drejtat e komuniteteve, decentralizimin, mbrojtjen e Kishës Ortodokse Serbe, dhe sundimin e ligjit. Këto autoritete ndërkombëtare do ta kishin pushtetin për ‘t’i përmirësuar veprimet,’ domethënë, të bëjnë veto në vendimet qeveritare lokale “që do t’i shkelnin dispozitat e propozimit të Zgjidhjes dhe frymën në të cilën këto ishin përpiqur.”⁶ Pas përpjekjeve të pasuksesshme për përvetësimin e një rezolute të Këshillit të Sigurimit të KB, më 17 shkurt 2008, Kuvendi i

⁶ Për më tepër hollësi lidhur me propozimin e Ahtisaarit shih, United Nations, “Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo’s Future Status,” S/2007/168, 26 mars 2007.

Kosovës e miratoi Deklaratën e Pavarësisë. Kjo Kosovën e shpallte si një republikë demokratike, sekulare dhe multi-etnike, që i pranonte në tërësi obligimet sipas propozimit të Ahtisaarit.⁷ Ndërkohë Shqipëria, Kroacia dhe Mali i Zi tanimë janë bërë anëtare të plotfuqishme të NATO-s. Maqedonia me hapa jashtëzakonisht të shpejtë po shkon drejt anëtarësimit, ndërsa Kosova dhe qytetarët e saj që 11 vjet gëzojnë privilegjin e shtetit të tyre të pavarur.

Intervenimi i NATO-s njëkohësisht shënon edhe fillimin e asaj që në Marrëdhëniet Ndërkombëtare njihet si ‘Intervenim Humanitar’, e që nënkupton të drejtën e shteteve të ndërgjeshme demokratike për të ndërhyrë ndaj shteteve të cilat ushtrojnë terror dhe gjenocid ndaj popullatës civile të pambrojtur. Nga ky moment asnjë diktator apo regjim autoritar nuk do të guxonte që në mënyrë të egër t’i diskriminon dhe t’i shkel të drejtat e qytetarëve të vetë. Madje me kalimin e kohës u zhvillua edhe koncepti i të ‘drejtës për të intervenuar’ dhe ‘detyrës për të mbrojtur’.⁸ Duhet theksuar se intervenimi ushtarak në luftën e Kosovës ishte ndërhyrja e parë e NATO-s ndaj një shteti pa mandatin e OKB-së dhe ky moment shtroi pyetjen, deri në çfarë mase intervenimet ushtarake janë legjitime në aspektin e të drejtës ndërkombëtare? Ky diskutim është formësuar nga edhe nga aspekti i ligjshmërisë, por edhe nga aspekti moral. Padyshim se intervenimi ushtarak NATO-s në Kosovë në shumë pikëpamje paraqet një pikë kthese në historinë e Aleancës dhe anëtarëve të saj. Ishte hera e parë në historinë e Organizatës së

⁷ Oisín Tansey, “Kosovo: Independence and Tutelage,” *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, prill 2009, f. 159.

⁸ Për një spjegim të detajuar lidhur me të drejtën për të intervenuar dhe detyrën për të mbrojtur, shih Terry Nardin, “From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention,” *The European Journal of International Law*, Vol. 24 no. 1, 2013, f. 67-82.

Traktatit të Atlantikut të Veriut që ndërmerre një veprim ushtarak jashtë territorit të shteteve anëtare të NATO-s, madje pa një mandat paraprak të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.⁹ Si i tillë, intervenimi ushtarak i NATO-s është bërë temë studimi dhe debati nga studjuesit e të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare që vazhdon edhe sot. Ndonëse mendimet janë të ndara, shumica e studjuesve ndan mendimin se nëse jo ligjërisht, atëherë në aspektin moral, intervenimi i NATO-s është i arsyeshëm.¹⁰

Pra, aty ku shkeljet e të drejtave të njeriut kanë për pasojë dëbimin e dhunshëm të një popullsie të tërë, çështja e intervenimit ndërkombëtar bëhet e domosdoshme dhe e ligjshme. Në favor të kësaj përmenden edhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën, përmes të cilave nënvizohej brenga për situatën në Kosovë dhe tërhiqej vërejtja për katastrofën e mundshme humanitare dhe në të njëjtën kohë nga palët në konflikt kërkohej gjetja e një zgjidhje negociuese. Por, këto rezoluta nuk patën ndonjë efekt pozitiv, ndaj Këshilli i Sigurimit në shtator të vitit 1998 miratoj Rezolutën 1199, duke u mbështetur në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, që konsiderohej si hap i parë drejt masave më të ashpra të

⁹ Syle Ukshini, "Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë katalizator për zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës ndërkombëtare," *Radio Kosova e Lirë*, 26 mars 2018; <https://www.radiokosovaelire.com/syle-ukshini-nderhyrja-ushtarake-e-nato-s-ne-kosove-katalizator-per-zhvillimin-e-metejshem-te-se-drejte-nderkombetare/>.

¹⁰ Shih për shembull Paul Latawski & Martin A. Smith, "NATO, Kosovo and 'humanitarian intervention' in The Kosovo crisis and the evolution of post-Cold War European security, Manchester University Press, 2003; Iulia Elena SOCEA, "NATO's Military Intervention in Kosovo and the Diplomatic Alternative," *Revista Romaneasca pentru Educatia Multidimensionala*, September 2006 dhe John Janzekovic, *The Use of Force in Humanitarian Intervention*, London: Ashgate Publishing, 2006.

ndërmarra nga Këshilli i Sigurimit, të cila mund të shkonin deri tek intervenimi ushtarak. Në këtë sfond, operacioni “Allied Force” – ndërhyrja humanitare e NATO-s në Kosovë – konsiderohet si intervenim i domosdoshëm dhe i ligjshëm, për faktin se Milosheviq nuk ishte i gatshëm për përmbushjen e kërkesave dhe detyrimeve të një varg rezolutave të OKB-së dhe as të heqjes dorë nga operacionet ushtarake dhe nga politika e spastrimit etnik në Kosovë.¹¹ Po ashtu, argument për intervenimin ushtarak të NATO-s nënvizohet shterimi i të gjitha mjeteve diplomatike dhe përpjekjeve ndërmjetësuese të Grupit të Kontaktit nga viti 1997 e deri në Konferencën e Rambujesë dhe nga ana tjetër fitimi i kohës nga pala serbe për dislokimin e trupave ushtarake në Kosovë si dhe vazhdimi i operacioneve ushtarake. Meqë shtetet anëtare të NATO-s intervenuan ushtarakisht për të mbrojtur popullatën kosovare brenda shtetit sovran të Jugosllavisë së mbetur, padyshim se bëhej fjalë për një intervenim me karakter humanitar. Mbi të gjitha aksioni ushtarak i NATO-s nuk ishte as mbrojtje në një luftë ndërshtetërore në kuptimin klasik, por një përgjigje e NATO-s ndaj dëbimit të popullatës shqiptare nga Kosova. NATO intervenoi ushtarakisht, jo vetëm pse Serbia nuk e kishte pranuar Planin e Rambujesë, por se forcat e tij ushtarake, policore dhe paramilitare prej kohësh kishin filluar të dëbonin popullsinë shqiptare nga Kosova.

Ky intervenim ka rëndësi të veçantë edhe për faktin se Qeveria e Maqedonisë për herë të parë u vu në anën e Kosovës viza vi Serbisë duke i vënë në dispozicion forcave të NATO-s hapësirën e saj tokësore dhe ajrore dhe duke hapur dyert për refugjatët nga Kosova. Deri atëherë, Maqedonia gjithmonë është rreshtuar në anën e Serbisë dhe jo të Kosovës. Një arsye për një gjë të tillë gjithsesi

¹¹ Ukshini, 2018.

ndërlidhet me raportet miqësore mes Serbëve dhe Maqedonasve gjatë ish-Jugosllavisë. Për Maqedonasit etnikë, Shqiptarët gjithmonë janë konsideruar si të rrezikshëm dhe se kanë për qëllim ta shpëpusin një pjesë të territori të Maqedonisë dhe t'ia bashkangjesin Shqipërisë apo Kosovës. Nga na tjetër, një arsye tjetër padyshim është edhe bashkëpunimi i ngjeshur ekonomik Maqedoni-Serbi deri në vitin 1999. Jo vetëm që Maqedonia eksportonte shumë nga prodhimet e saj në Serbi, por gjithashtu importonte shumë, duke përfshirë edhe lëndët e para për industrinë e vet. Që nga fillimi i fushatës së NATO-s, tregëtia maqedonase me Serbinë ishte bllokua tërësisht. Si rezultat, një numër i fabrikave ishin mbyllur, ndërkaq që shumë punonjës ishin detyruar në pushim pa papagesë ose madje edhe humbje të vendit të punës.¹² Marrë të gjitha këto parasysht, nuk është çudi që hapi i këtillë i qeverisë u kundërshtua nga një pjesë e madhe e qytetarëve maqedonas.

Si rezultat, një ditë pas fillimit të sulmeve, me 25 mars 1999, rreth 5,000 njerëz protestuan në qendër të Shkupit për më tepër se shtatë orë, duke shkatërruar dhe djegur vetura të SHBA-së dhe OSBE-së. Po atë ditë u tentua të digjet edhe Ambasada e SHBA-së e cila atëherë gjindej në lokalet ku sot funksionon dhe vepron me shumë sukses dhe përkushtim Instituti për Trashëgiminë Shpirtore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni. Edhe pse zyrtarisht thuhej se protesta ishte organizuar nga pakica serbe, ishte e qartë se ishte mbështetur në mënyrë masovike nga të rinjtë maqedonas. Poashtu, pas fillimit të sulmeve nga ajri, Kisha Ortodokse e Maqedonisë, e cila për ironi nuk është e pranuar nga Kisha Ortodokse Serbe, lëshoi një deklaratë sipas së cilës sulmi ndaj Serbisë ishte sulm ndaj

¹² "Macedonia: Towards Destabilization?", ICG Report N° 67, Skopje/Brussels, 21 May 1999, f. 8.

të githë besimtarëve orthodoksë. Poashtu në këtë deklaratë theksohej se fatkeqësisht, për shkak se ishte shtet i vogël, Maqedonia nuk ishte në gjendje të luftonte përkrah vëllezërve të saj Serbë. Duhet theksuar se pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, një fluks tejet i madh i refugjatëve nga Kosova ishte nisur drejt Maqedonisë. Para fillimit të sulmeve në Maqedoni ishin vendosur rreth 20,000 refugjatë, kryesisht nga fshatrat afër kufirit. Dy javë pas fillimit të bombardimeve, në Maqedoni arritën edhe 50,000 refugjatë të tjerë, ndërkaq që edhe 120,000 të tjerë oritinin ta kalonin kufirin.¹³ Nga frika e prishjes së balancit etnik që do ta rrezikonte stabilitetin e brendshëm, Maqedonia fillimisht ta hapte kufirin dhe t'i pranonte rreth 280,000 refugjatë kosovarë. Pra qeveria asokohe ndodhej në presion të dyanshëm. Bashkësia ndërkombëtare dhe qytetarët shqiptarë në Maqedoni insistonin që ta hapeshin kufijtë për refugjatët nga Kosova. Nga ana tjetër, qytetarët maqedonas, të cilët në masë të madhe kishin qëndrim pro-serb dhe anti-shqiptar, rregulisht protestonin kundër pranimin të refugjatëve.¹⁴ Falë skenave të tmerrshme nga kufiri i Bllacës që shetitën botën, qeveria vendosi t'i pranonte refugjatës nga Kosova, dhe deri më 8 maj 1999, në Maqedoni kishin arritur 235,300 refugjatë. Kjo shifër ishte 11 herë më e lartë nga ajo që qeveria e kishte vendosur si të pranueshme në vendimin e saj në muajin shkurt.¹⁵ Fatmirësisht, frika se ky numër do ër mund ta destabilizonte Maqedoninë dhe ta prishte balancin etnik nuk u

¹³ Kyрил Drezov, "Collateral Damage: The Impact on Macedonia of Kosovo War," in Michael Waller, Kyрил Drezov and Bülent Gökay eds. *Kosovo: The Politics of Delusion*, London: Frank Cass Publishers, 2001, f. 62.

¹⁴ Klemenčić, Mladen. "Threats to Macedonia's Stability and Borders," *IBRU Boundary and Security Bulletin*, Spring 2001, f. 76.

¹⁵ OSCE Spillover Monitor Mission to Skopje, Fortnightly Report, 23 March-11 April 1999.

realizua, sepse shumica e refugjatëve u kthyen në Kosovë gjatë verës të vitit 1999.¹⁶

4. Përfundim

Këtë vit është shënuar 20 vjetori i fillimit të bombardimeve të NATO-s ndaj forcave ushtarako-policore serbe në Kosovë dhe Serbi. Me 24 mars, para 20 vitesh Aleanca ushtarake më e fuqishme në botë vendosi të intervenonte për të mbrojtur popullatën civile të shqiptarëve në Kosovë nga terrori i hordhive ushtarake-policore dhe paramilitare të Millosheviqit. Ky intervenim i atëhershëm i NATO-s do të ketë pasoja të jashtëzakonshme për Kosovën në veçanti, por edhe për rajonin dhe gjithë botën në përgjithësi. Falë këtij intervenimi, qytetarët e Kosovaës fituan lirinë dhe më vonë edhe pavarësinë e shtetit. Kjo ndërhyrje e NATO-s poashtu e hapi rrugën për integrimin e shteteve të rajonit në NATO. Sot Shqipëria, Kroacia dhe Mali i Zi janë anëtarë të plotëfuqishëm të aleancës, ndërkaq që Maqedonia me hapa jashtëzakonisht të shpejtë po shkon drejt anëtarësimit. Nga aspekti i të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, kjo ndërhyrje e NATO-s është bërë temë studimi dhe debati nga ekspertët e ndryshëm në mbarë botën. Ndonëse ekzistojnë mendime të ndryshme, shumica e studjuesve ndan mendimin se nëse jo ligjërisht, atëherë në aspektin moral, intervenimi i NATO-s është i arsyeshëm. Intervenimi i NATO-s njëkohësisht shënon edhe fillimin e asaj që në Marrëdhëniet Ndërkombëtare njihet si ‘Intervenim Humanitar’, e që nënkupton të drejtën e shteteve të ndërgjeshme demokratike për të ndërhyrë ndaj shteteve të cilat ushtrojnë terror dhe gjenocid ndaj popullatës civile

¹⁶ Eleni Koppa, Maria, “Ethnic Albanians in the Former Yugoslav Republic of Macedonia: Between Nationality and Citizenship,” *Nationalism & Ethnic Politics*, Vol. 7, No. 4, 2001, f. 53.

të pambrojtur. Me kalimin e kohës, intervenimi humanitar ka çuar deri te zhvillimi i konceptit i të 'drejtës për të intervenuar' dhe 'detyrës për të mbrojtur.' Së fundi, intervenimi i NATO-s para 20 vitesh ka rëndësi të posaçme sepse Qeveria e Maqedonisë për herë të parë u vu në anën e Kosovës viza vi Serbisë duke i vënë në dispozicion forcave të NATO-s hapësirën e saj tokësore dhe ajrore dhe duke hapur dyert për refugjatët nga Kosova. Edhe pse shumica e qytetarëve maqedonas, kishte qëndrim pro-serb dhe anti-shqiptar, qeveria e Maqedonisë falë aspiratave euro-atlantike doli në anën e Kosovës.

Literatura:

Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, "Interethnic Relations in the Western Balkans Implications for Kosovo." Policy Paper No. 6/14, Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED), dhjetor 2014.

Avdullah Robaj, "Demokracia parlamentare dhe shteti i së drejtës në Republikën e Shqipërisë", Universiteti Mbretëror "Iliria", Prishtinë, 2007.

Eleni Koppa, Maria, "Ethnic Albanians in the Former Yugoslav Republic of Macedonia: Between Nationality and Citizenship," *Nationalism & Ethnic Politics*, Vol. 7, No. 4, 2001.

Iulia Elena SOCEA, "NATO's Military Intervention in Kosovo and the Diplomatic Alternative," *Revista Romaneasca pentru Educatia Multidimensionala*, September 2006.

John Janzekovic, *The Use of Force in Humanitarian Intervention*, London: Ashgate Publishing, 2006.

Kyryl Drezov, "Collateral Damage: The Impact on Macedonia of Kosovo War," in Michael Waller, Kyryl Drezov and Bülent Gökay eds. *Kosovo: The Politics of Delusion*, London: Frank Cass Publishers, 2001.

“Macedonia: Towards Destabilization?,” ICG Report N° 67, Skopje/Brussels, 21 May 1999.

Marie-Janine Calic, “Kosovo in the twentieth century: A historical account,” në Ramesh Thakur dhe Albrecht Schnabel red., *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship*, United Nations University Press, Tokyo, dhjetor 2000.

Mladen Klemen i , "Threats to Macedonia's Stability and Borders," *IBRU Boundary and Security Bulletin*, Spring 2001.

Oisín Tansey, “Kosovo: Independence and Tutelage,” *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, prill 2009.

OSCE Spillover Monitor Mission to Skopje, Fortnightly Report, 23 March–11 April 1999.

Paul Latawski & Martin A. Smith, “ NATO, Kosovo and ‘humanitarian intervention’ in The Kosovo crisis and the evolution of post–Cold War European security, Manchester University Press, 2003.

”SHENJA,” E Përnuajshme Mbarëkombëtare Politike,Ekonomike dhe Kulturore, Nr.28.Gusht, 2013.

Syle Ukshini, “Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë katalizator për zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës ndërkombëtare,” *Radio Kosova e Lirë*, 26 mars 2018; <https://www.radiokosovaelire.com/syle-ukshini-nderhyrja-ushtarake-e-nato-s-ne-kosove-katalizator-per-zhvillimin-e-metejshem-te-se-drejte-nderkombetare/>

Terry Nardin, “From Right to Intervene to Duty to Protect: Michael Walzer on Humanitarian Intervention,” *The European Journal of International Law*, Vol. 24 no. 1, 2013, f. 67–82.

United Nations, “Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo’s Future Status,” S/2007/168, 26 mars 2007.

Yannis, Alexandros, “The UN as Government in Kosovo,” *Global Governance*, Nr. 10, 2004.

DR. ENVER HOXHAI

Zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës

QË NGA VITI 1999, EDHE HISTORIA ËSHTË NË ANËN TONË

Fillimisht dua ta falënderoj Institutin për Trashëgiminë Shqiptare në Maqedoninë Veriore, në Shkup, për organizimin e kësaj ngjarjeje mjaft të rëndësishme, dhe ta falënderoj për ftesën. Po ashtu, dua t'i jem shumë mirënjohës z.Ali Ahmeti, por edhe gjithë kolegëve në qeveri, në Shkup, të cilët çdoherë po i shënojnë të gjitha ngjarjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me Kosovën, që kanë të bëjnë me Shqipërinë... Por, në veçanti ato që kanë të bëjnë me Kosovën, meqë arritjet e Kosovës janë edhe arritje të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Liria dhe pavarësia jonë e kanë në themel gjakun, sakrificën dhe kontributin e vëllezërve dhe motrave tona këtu në Maqedoni, dhe u jemi shumë mirënjohës për këtë kontribut të madh që keni dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Sot jemi mbledhur për ta shënuar një ngjarje që ka ndodhur 20 vjet më parë, 24 marsin e vitit 1999. Mund të flasim gjatë, mund të themi shumë, mund të kemi pikëpamje të ndryshme, dhe mund të bëjmë analiza të shumta, por unë dua t'i përmendi tri çështje apo tre dimensione, se si e kuptojmë ne këtë ngjarje.

Së pari, është një ngjarje që së bashku me luftën e UÇK-së, intervenimi ushtarak i NATO-s mbi Serbinë, e ndanë dhe e prejnë një epokë me një epokë tjetër! Unë e di që ndonjëherë në gjuhën shqipe, fjalën 'epokë' e përdorim vend e pa vend, por nëse ka një ngjarje e cila realisht e mbyllë një epokë (robërinë) dhe e hapë një epokë tjetër (lirinë), për mendimin tim është periudha mes 24

marsit dhe 12 qershorit të vitit 1999. Dhe, kjo ngjarje nuk i jep fund vetëm një robërie, por i jep fund çdo robërie në rajon që ka eksistuar në raport me shqiptarët. Kjo është prerja dhe përmbyllja më interesante, dhe mbi të gjitha është një lloj triumfi i besimit, i shpresës, edhe i drejtësisë mbi forcat e errëta të historisë, ndërsa viktimat e atyre forcave të errëta, janë shumë qytetarë të Kosovës. Intervenimi i NATO-s e parandaloi gjenocidin, por nuk e kishte mundësinë ta parandalojë spastrimin e etnik, i cili i ndodhi Kosovës qoftë përmes vrasjeve masive, qoftë përmes shkatërrimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në lidhje me shpopullimin masiv, spastrimin etnik të Kosovës, u jemi falënderues shumë vëllezërve për pritjen këtu në Maqedoni që e kanë bërë gjatë luftës.

Por, përtej dimensionit ushtarak mbi Serbinë, ka edhe një gjë që duhet të kuptohet drejtë. Marrëveshja e Rambujesë, e para 24 marsit, ishte marrëveshja e parë e Kosovës me perëndimin, dhe natyrisht edhe marrëveshja e 12 marsit (e Kumanovës), e shndërron Kosovën prej një entiteti jugosllav në një entitet ndërkombëtar, që është një parakusht për një shtet sovran dhe të pavarur. Pa vullnetin e pathyeshëm të shqiptarëve të Kosovës dhe të shqiptarëve kudo në rajon, dhe veçanërisht nga mbështetja që kemi marrë nga shqiptarët në Maqedoni, pa rezistencën civile, pa luftën e UÇK-së, pa 24 marsin 1999, nuk do ta kishim edhe marrëveshjen tonë të dytë me perëndimin – Pavarësinë e Kosovës.

Së dyti, në politikë ka nga një vit që është vit kthesë, vit i transformimit, ka vit ku hapet një dritare e re e mundësisë, ku ndodhë ndryshimi kualitativ, që nuk kishte ndodhur 10, 20 apo 30 vite rigide të mëparshme! Natyrisht që komunizmi në ish-Jugosllavi dhe në Ballkan filloi të bie në vitin 1990, dhe Jugosllavia ka filluar të shpërbëhet në vitet e '90-ta, por shpërbërja e saj e mirëfilltë

ndodh pikërisht në vitin 1999 me rënien e një komunizmi në formën e fashizmit të manifestuar me emrin e Slllobodan Millosheviqit. Prandaj, viti 1999 është një vit i kthesës, dhe gurthemel i fundit i një paqeje evropiane është Marrëveshja e Kumanovës e 12 qershorit 1999. Pa Marrëveshjen e Kumanovës nuk do të kishte as demokratizim të Ballkanit, as ndryshim të regjimit në Serbi, as krijim të parakushteve jo vetëm të pavarësisë së Kosovës, por edhe të Malit të Zi. Por, mbi të gjitha është viti më vendimtar për evropianizimin dhe demokratizimin e rajonit tonë. Prandaj, edhe sot pas 20 viteve, harta e Ballkanit është krejt tjetër – pothuajse më tepër se gjysma e shteteve janë anëtare të BE-së dhe të NATO-s. Veçanërisht, sukseset të cilat i ka pasur Maqedonia Veriore, do të ishin të pamundura pa rolin e faktorit shqiptar, i cili është faktori më properëndimor në këtë vend. Marrëveshja e Prespës, zyrtarizimi i gjuhës shqipe, nënshkrimi i protokollit të vendit tuaj me vendet anëtare për t'u anëtarësuar në NATO, janë ngjarje të cilat e kanë ndikimin e tyre jo vetëm se në Maqedoninë Veriore, por edhe në tërë rajonin. Pas 20 vitesh, ne nuk jetojmë më në një epokë të rivalitetit, por në një epokë të bashkëpunimit. Çdo ecje përpara e një vendi, është ecje përpara e rajonin, dhe çdo dështim i ndonjë vendi të rajonit, është dështim i të gjitha shteteve.

Së treti, 24 marsi është një ngjarje e madhe ndërkombëtare, dhe këtë e dëshmon edhe vëmendja e madhe mediatike që i kushtohet edhe këtyre ditëve, 20 vjet më pas. Intervenimi ushtarak mbi Serbinë dhe shpëtimi i popullit të Kosovës, është rezultat i ngritjes së SHBA-ve si superfuqi dhe fuqizimit të Bashkimit Evropian. Ndërsa, për neve në Ballkan, dhe veçanërisht në Kosovë, ka qenë mundësia e fundit me e pa portën e historisë të hapur, dhe me e zënë këtë shans të historisë. Në fillim të shekullit XXI, në këto dy

dekada, shqiptarët kudo që jetojnë, janë faktor i mirëfilltë politik, gjeopolitik, ekonomik dhe kulturor, por ngritja jonë u bë vetëm si rezultat i ngritjes së partnerëve tanë, andaj me çdo kusht partneriteti duhet ruajtur edhe më tej, veçanërisht me SHBA-në dhe BE-në.

Por ka mbetur edhe diçka që duhet të përmbyllet! Nëse në '99-tën kemi triumfuar ushtarakisht mbi Serbinë edhe në planin diplomatik, në 2019 përmes një marrëveshje të mundshme të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila duhet të nënkuptojë njohje të ndërsjellët, e cila duhet të nënkuptojë vendosje të marrëdhënieve diplomatike, e cila duhet të nënkuptojë anëtarësim të Kosovës në OKB, ne mund ta përmbyllim një prej sfidave të fundit historike që ka rajoni, siç është raporti mes Kosovës dhe Serbisë.

Ngjarjet historike nuk janë dhe nuk duhet të shërbejnë si ngjarje që kujtohen dhe të mbesin në histori, por janë ngjarje që duhet të shërbejnë se si ta tejkalojmë historinë! Unë mendoj se që nga viti 1999, edhe historia është në anën tonë, dhe duhet ta shfrytëzojmë këtë shans që të ecim përpara.

Zotëri drejtor, duke ju falënderuar dhe njëherë për shënimin e kësaj ngjarjeje, dua t'ju them edhe juve edhe z.Ahmeti, por edhe gjithë shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, që ju jemi shumë – shumë mirënjohës për kontributin tuaj, por në të njëjtën kohë, gjatë tërë punës tonë, ju kemi edhe në zemër dhe mendje, aq sa mundemi me bë për ju këtu!

Ju faleminderit!

ALI AHMETI

Kryetar i BDI-së

LIRINË E FITUAM ME GJAKUN TONË, POR ÇLIRIMIN ME NATO-n

Sot është një ditë jashtëzakonisht e veçantë, e cila na kthen pas për të nënvizuar, por edhe për të përkujtuar tërë lëvizjen e kombit tonë për liri, drejtësi e barazi.

Jugosllavia ishte e përkëdhelura e Evropës. Pak dëgjohej zëri i arsyeshëm i shqiptarëve që rrezikonin dhe sakrifikonin për lirinë e tyre që nga koha e vendosjes së pushtetit ushtarak, apo pas “çlirimit” nga Lufta e Dytë Botërore.

Çdo të arritur brenda atij regjimi, shqiptarët e bënë me sakrificë, duke paguar me jetë, duke derdhur gjak, duke vuajtur nëpër burgje me mijëra të rinj, studentë nga të gjitha trevat që nga Gjevgjelia e deri në Jesenicë. Burgjet qenë të mbushura përplot me të rinj dhe të reja shqiptare, vetëm e vetëm që të jenë të lirë, të barabartë, që të jenë zot në shtëpitë e vet, për gjuhë, kulturë e arsim. Por, të gjitha këto përfundonin në vesh të shurdhur, ku çmimi ishte gjaku dhe burgosja.

Në vitin 1968, shqiptarët të organizuar dhe të mobilizuar mirë, edhe pse duke paguar çmim, arritën ta zyrtarizojnë flamurin e tyre kombëtar, arritën të realizojnë Universitetin e Prishtinës, që më vonë do të shndërrohet në një tempull të shenjtë për t’i bashkuar të gjithë shqiptarët nga Ulqini e deri në Manastir, Strugë e Ohër. U shndërrua në një tempull ku bëheshin organizime të mirëfillta për të avancuar kërkesat e shqiptarëve për të drejta të arsyeshme. Regjimi

ekspansionist i kohës, shovinistët, s'donin të dëgjojnë fare për këto çështje, dhe e gjitha përfundoi me dhjetëra e dhjetëra studentë të vrarë e me mijëra të burgosur.

Por, nuk mund të mbahet një komb i poshtëruar, i persekutuar, i vrarë dhe i gjakosur. U deshtën shumë e shume organizime, u desh-të që të shkrihet një familje e tërë, si familja Jashari, e që të trokasë në ndërgjegjen e Evropës dhe botës, se ky vend dhe ky popull kërkon liri, dhe s'pyet për çmim, qoftë edhe ai më i shtrenjti, që të zhduket familja e tërë, ashtu edhe siç u zhdukën.

Këtë realitet, më së miri, më drejt dhe më shpejtë e kuptuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me çka e vunë në lëvizje tërë diplomacinë ndërkombëtare, dhe skenën politike, si në Londër, Berlin, Paris, se po zhduket një komb i tërë, dhe se po bëhet gjenocid ndaj një populli të tërë!

Vëllezër e motra!

Lirinë kombëtare e fituam me gjakun e derdhur të kombit tonë, por çlirimin e arritëm përmes intervenimit të NATO-s në këto hapësira. Dhe, nuk u çlirua vetëm Kosova, por u çlirua edhe Ballkani, sepse sot forcat e NATO-s janë prezentë në Slloveni, Kroaci, Mali të Zi, e nesër do të jenë edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Prandaj, NATO-ja është vendimi shumë i drejt, por edhe jetik e strategjik i SHBA-së dhe i aleatëve të saj në Evropë. Ai vendim ishte sa i drejtë aq edhe largpamës, sepse ua ndaloi turrin forcave ekspansioniste të motivuara nga Kremli për të qenë dominante në hapësirat e Ballkanit perëndimor, dhe për të ushtruar ndikim e agresion, gjoja se në emër të demokracisë dhe vullnetit të lirë, që ne

të pranojmë dhe të mbështesim regjime që kurë s'i kemi mbështetur e as nuk do i mbështesim.

Prandaj, jemi mirënjohës për jetë të jetëve, dhe porosi brez pas brezi t'ju lejmë gjeneratave pas nesh, sepse NATO-ja ishte ajo që na ndihmoi, NATO-ja ishte që përfundimisht i çliroi hapësirat tona. Përndryshe, këtu edhe sot do ishim në luftë, Ballkani do të ishte në zjarr! Kështu që, mirë që u kuptua drejtë dhe në kohë, që mos të përsëritej një Bosnjë e dytë edhe në Republikën e Maqedonisë, ku NATO-ja u angazhua dhe u mobilizua aq shpejtë sa që këtë vend e shpëtoi nga një tragjedi e vërtetë në vitin 2001.

Prandaj, ky është motivi që ne në këtë 20-vjetor kaq të rëndësishëm për ne, e rikujtojmë dhe japim porosi për brezat që vijnë: Lirinë po me gjakun tonë, por çlirimin me aleatin më të madh politiko-ushtarak NATO, e realizuam në Kosovë dhe më gjerë.

Faleminderit për kohën Tuaj!

II.

TRIBUNË SHKENCORE

20–VJETORI I EKSODIT

TË SHQIPTARËVE NGA KOSOVA

SHKUP, 05.04.2019



Paneli i tribunës shkencore

*(Nga e majta: Zeqirija Ibrahim, Jahja Lluka, Sevdail Demiri,
Skender Asani, Sait Saiti)*

PROLOG

U bënë 20 vjet nga lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, gjatë të cilës ndodhi intervenimi energjik i trupave ushtarake të NATO-s mbi makinerinë vrastare serbe, gjë që nxiti reagimin agresiv të regjimit të Millosheviqit me qëllim spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët.

U bënë plot 20 vjet nga pranvera e '99-tës, kur afër gjysmë milioni shqiptarë të Kosovës, u detyruan dhunshëm t'i lëshojnë vatrat e tyre stërgjyshore.

Dy ishin shtigjet kryesore të deportimit të qindra-mijëra fëmijëve, grave e pleqve, të cilat risillnin në kohë moderne imazhet e zymta të deportimit të hebrenjve nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore: Kufiri i Bllacës së Shkupit dhe Morina e Kukësit, të cilat po dyndeshin nga fluksi i jashtëzakonshëm i të dëbuarve shqiptarë nën tytën e pushkës.

Në këtë kohë, përkundër plogështisë së strukturave qeveritare maqedonase për të mirëpritur të ikurit nga lufta, populli zemërbardhë i këtyre viseve, pati një solidarizim të jashtëzakonshëm me vëllezërit e tyre andej kufirit. Shtabet e para emergjente të krizës humanitare që po trokiste, u hapën nga populli shqiptar disa ditë para organizimeve institucionale, madje edhe para shoqatave bamirëse, siç ishte rasti me Kumanovën, të cilës ato ditë i vinte era bukë.

Në këto ditë të fundmarsit '99, u mobilizuan si asnjëherë më parë vullnetarë nga të gjitha anët, përmes shoqatave të ndryshme humanitare, për t'i furnizuar të dëbuarit me bukë e ujë, veshmbathje e strehim.

20 vjet pas atyre ngjarjeve të llahtarshme, u mbledhëm në këtë panel, për të kujtuar eksodin biblik të Bllacës, dhe për të debatuar lidhur me aktivitetet institucionale të atyre ditëve, që do ta betonin kujtesën kolektive të popullit tonë edhe përmes nismave konkrete.

Në palelin e moderuar nga Dr. Sevdail Demiri, ishin:

- Dr. Skender Asani, historian dhe drejtor i ITSHKSH–Shkup;
- Mr. Jahja Lluka, kryetar i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta – Prishtinë;
- Dr. Sait Saiti, sekretar i përgjithshëm i Kryqit të Kuq në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Dr. Zeqirija Ibrahim, bashkëpunëtor i lartë shkencor në ITSHKSH, dhe ish–aktivist humanitar në kohën e krizës humanitare në Bllacë.

Secili nga referuesit prezantoi pikëpanjet e tij lidhur me temën, e pastaj pati edhe debati të frytshëm përmes komenteve dhe pyetjeve të të pranishmëve.

5 Prill 2019

ITSHKSH – SHKUP

DR. SKENDER ASANI

Drejtor i ITSHKSH – Shkup

BLLACA, HOLOKAUSTI SHQIPTAR

Në vitin 2019 shënohet 20–vjetori i Luftës së Kosovës!

Por, viti 1999 mbahet mend edhe me sulmet e NATO–s, me krizën humanitare të civilëve dhe me krizën e refugjatëve, që kulminoi me shtatë ditët e qëndrimit në qiell të hapur, në hapësirën ndërkuftare në Bllacë, të kosovarëve të përndjekur nga regjimi i Millosheviqit!

Ngjarja e pranverës së vitit 1999, kur më 24 mars filluan sulmet e NATO–s mbi caqet ushtarake serbe, përfundimisht ndryshoi edhe politikën globale.

Guximi i Presidentit Clinton dhe Kryeministrit Bler, që të ndërmerren sulme ajrore dhe të pengohet përsëritja e Srebrenicës edhe në Kosovë, ishte çasti i parë kur NATO do të reagojë me kohë e vendosmëri dhe shpëtoi një popull të tërë nga shfarrowja fizike (holokausti).

Dhe, ky është një moment që nuk mund të nëpërkëmbet dhe të merret dosido. E kur kësaj ngjarje globale ia shtojmë katastrofën humanitare të civilëve, që në fund të marsit të atij viti u përzunë dhunshëm nga vatrat e tyre, me synimin millosheviqian të pastrimit etnik të Kosovës, gjë që shkaktoi valë të paparë të refugjatëve në kufirin Kosovë–Maqedoni, ku janë shënuar edhe tragjedi të mëdha njerëzore, konsiderojmë se ky 20–vjetor meriton qasje serioze dhe të përkushtuar.

Prandaj, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, ka përgatitur një elaborat që ua dorëzoi dy qeverive, asaj të Maqedonisë së Veriut dhe të Kosovës, që përvjetori në fjalë të shënohet me inaugurimin e një qendre përkujtimore dinjitoze në pikën ku ndodhi katastrofa humanitare në Bllacë.

E kemi propozuar Bllacën jorastësisht dhe jo vetëm sepse aty është dëshmia faktike e vuajtjeve. Po, kjo është një pjesë e të vërtetës dhe nuk mund të mohohet. Bile, është jokorrekte që kjo të zëvendësohet me ndonjë pikë tjetër, siç mund të jenë kampet e refugjatëve në Stenkovec, Radushë, Çegran, Neproshten e gjetiu, sepse ato kanë qenë lagje të përkohshme që nuk janë esenca nuk kuptimin historik. Ato janë të rëndësishme vetëm si orbita të Bllacës, por pa Bllacën nuk kanë asnjë kuptim. Kjo sepse Bllaca është epiqendra e asaj vuajtjeje dhe eksodi masiv.

Derisa qëndronin në Bllacë, shqiptarët e Kosovës regjistruan vuajtje, vdekje, uri, të ftohtë, trysni psikike etj... Ata që e kalonin Bllacën, shpëtonin, dhe ata që nuk e kalonin, përfundonin!

Bllaca, atëbotë, u bë kufi jo ndërmjet shteteve, por ndërmjet jetës dhe vdekjes!

Përveç kësaj, duke qenë kjo katastrofë humanitare pikërisht në fund të shekullit XX, Bllaca mund të jetë metaforë edhe e të gjitha vuajtjeve të shqiptarëve nga viti 1913 e këndej.

Në Bllacë vuloset vuajtja e vaji dhe aty personifikohen shpërnguljet e shqiptarëve që kanë ndodhur gjatë gjithë shekullit. Aty është “Muri i vajtimit” të shqiptarëve për “Eksodin” që e përjetuan.

Nisur nga kjo, jam i mendimit se 20-vjetori i kësaj ngjarje nuk duron improvizime politike e karikaturime të çastit, por kërkon një qasje serioze shtetërore e shkencore. Pos kësaj, vendosja e kësaj

qendre përkujtimore në Bllacë, do të duhet të shërbejë edhe si gurthemel i marrëdhënieve të mira të Maqedonisë dhe Kosovës, si peng kujtimi për atë ngjarje. Ajo pikë është jo vetëm guri i kufirit, por është edhe kujtesë se atëbotë Maqedonia – e gjetur ngushtë nga vala e madhe e refugjatëve, pas ndihmës ndërkombëtare – i hapi dyert dhe pranoi gati gjysmë milion njerëz.

Nëse sot në botë është i rëndësishëm një person që ka ndihmuar në shpëtimin e hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore, dhe emri i tij shënohet në qendrat më të rëndësishme përkujtimore të holokaustit të hebrenjve, atëherë ndihma që Maqedonia ia ka ofruar Kosovës, më saktë popullatës civile të Kosovës, ka qenë jetike për ta.

Prandaj, përveçse interes i shqiptarëve andej e këndej kufirit, ky është edhe një interes shtetëror, që mundëson marrëdhënie të mira ndërshtetërore.

Bllaca është metaforë e holokaustit shqiptar në shekullin XX.

MR. JAHJA LLUKA

Kryetar i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta – Prishtinë

ZHVILLIMET NË KOSOVË, PAS INSTALIMIT TË REGJIMIT TË DHUNSHËM TË MILLOSHEVIQIT, E DERI TE GJENOCIDI NË BLLACË

Kosova shqiptare u bë pjesë e Serbisë në përfundim të luftërave të Ballkanit, në vitin 1913, e cila ngeli pjesë e saj edhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1974, reforma kushtetuese e Titos i dha njëfarë autonomie më të gjerë krahinës shqiptare të Kosovës por, në vitin 1987, i hallakaturi Millosheviq, mori pushtetin në Serbi. Ai, i mbështetur në platformën e vjetër nacionaliste serbe, bëri plane, reforma dhe veprime konkrete me synim heqjen e kësaj autonomie të fituar me gjak e me sakrifica nga populli etnik shqiptar në Kosovë. Qëllimi i tij i vetëm ishte pastrimi etnik i Kosoves dhe realizimi i planeve serbe për asgjësimin e popullit tonë duke filluar nga Naçertanja e deri te Potkoi.

Deri në vitin 1989, krahina shqiptare e Kosovës, gëzoi një nivel pothuajse më të lartë autonomie, gjithmonë nën ndikimin e Republikës jugosllave. Kur lideri kriminel serb Slllobodan Milosheviq mori titullin e kryetarit, kjo pak autonomi, që sapo kishte filluar frymëmarrjen e vet, u vendos në një kontroll të rreptë dhe të paparë historikisht: politik, policor, ushtarak, ekonomik, arsimor, kulturor,

drejtpërsëdrejti nga regjimi nacionalist dhe i pangopur i Beogradit dhe i shtetit të tij serb.

Ne vitin 1991, udhëheqësi shqiptar në Kosovë, Ibrahim Rugova, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, shpallën pavarësinë, duke përcaktuar që taktika e tyre të mbetej për mospërdorimin e dhunës. Në vitin 1995, Kosova u përjashtua nga agjenda e Dejtonit, ndërkohë që komuniteti evropian e njohu Republikën Federative të Jugosllavisë, me Kosovën si pjesë të saj.

Edhe në këtë moment, KE, fuqitë e mëdha perëndimore të Evropës, edhe pse kishin shansin e madh historik për të rregulluar gabimet e mëdha të bëra nga vetë qeveritë e tyre të mëparshme në kurriz të jetës qytetare dhe të trojeve etnike shqiptare, nuk mundën të rregullonin e të reflektonin sado pak për çështjen e pazgjidhur shqiptare në rajonin e Ballkanit.

Në vitin 1998, lufta ndërmjet ushtrisë kriminale e policore serbe dhe shqiptarëve të Kosovës, rezultoi me mbi 13.500 shqiptarë të vrarë dhe me më se 500.000 njerëz të dëbuar me dhunë nga shtëpitë, nga trojet dhe nga vatrat e tyre etnike.

Komuniteti përparimtar demokratik mbarëbotëror u interesua seriozisht për shkallëzimin e luftës, për pasojat njerëzore e humanitare, si dhe për mundësinë e kësaj katastrofe për t'u përhapur në shtete të tjera. Presidenti Milosheviq i priti me mospërfillje të gjithë zërat dhe përpjekjet diplomatike që synonin një zgjidhje paqësore të krizës në Kosovë.

Më 28 maj 1998, në takimin e zhvilluar në Këshillin e Atlantikut Verior, i mbajtur nga ministrat e Jashtëm të vendeve përkatëse, u vendosën dy objektivat më madhore të NATO-s, në respekt, në

vlerësim dhe në konsideratë të situatës alarmante e të krizës në Kosovë:

Së pari, të ndihmojë në arritjen e një zgjidhje paqësore të krizës, duke kontribuar edhe në dhënien e një përgjigjeje komunitetit ndërkombëtar. Së dyti, të sigurojë stabilitet dhe siguri në vendet fqinje, në mënyrë të veçantë në Shqipëri dhe në vendet e ish-Republikës së Jugosllavisë dhe në Maqedoni.

Më 12 qershor 1998, takimi i Këshillit të Atlantikut Verior, i organizuar nga ministrat e Mbrojtjes, kërkoi një takim për masat e mëtijshme që mund të merrte NATO për sa i përkiste zhvillimit të krizës në Kosovë. Kjo çoi në marrjen në konsideratë dhe në trajtimin e një numri zgjidhjesh të mundshme ushtarake.

Më 13 tetor 1998, duke parë një përkeqësim të situatës që u krijua në Kosovë, Këshilli i NATO-s autorizoi fillimin e sulmeve ajrore. Kjo lëvizje u bë e domosdoshme për të mbështetur përpjekjet diplomatike për të hequr forcat e regjimit famëkeq të Milosheviqit nga Kosova.

Nga ana tjetër, ky veprim bëhej i domosdoshëm për t'i dhënë fund dhunës mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare, si dhe për të lehtësuar rikthimin e refugjatëve të larguar shqiptarë për në shtëpitë e tyre.

Gjatë zhvillimeve të situatave dhe takimeve diplomatike, përfshirë këtu edhe vizitën e sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Solana, në Beograd, të dërguarit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Holbruk dhe Hill, shefat e Komitetit Ushtarak të NATO-s, gjeneralin Nauman dhe gjeneralin Klark, Milosheviqi pranoi të bashkëpunojë. Duke pasur besim te mashtuesi Milosheviq, u anulua autorizimi i lëshuar për sulme ajrore të NATO-s.

Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, shprehu interesin e thellë për luftën e armatosur, si dhe i bëri thirrje të dy palëve për të pushuar zjarrin. Në Organizatën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian, u ra dakord që në Kosovë të vendoset një mision verifikimi, për të vëzhguar përshtatjen e zonës.

Në këtë mënyrë, NATO vendosi një mision mbikëqyrës ajror. Vendosija e këtyre dy misioneve u ratifikua me Rezolutën 1203 të Këshillit të Sigurimeve të Kombeve të Bashkuara.

Lufta e popullit të Kosovës dhe involvimi ndërkombëtar:

Përtëritja e përpjekjeve ndërkombëtare u bë me qëllim që t'i jepet një mbështetje politike gjetjes së një zgjidhjeje paqësore për luftën, për gjenocidin, për krimet dhe për luftën e krijuar në Kosovë.

Menjëherë pas kësaj, ushtria serbe dhe forcat policore kriminale serbe, vazhduan me intensitet operacionet e tyre kundër shqiptarëve etnikë në Kosovë, duke futur trupa ekstra dhe tanke moderne, brenda rajonit, në kundërshtim të dukshëm me Marrëveshjen e tetorit.

Me qindra e mijëra njerëz të pafajshëm shqiptarë, gra, fëmijë, pleq të sëmurë e të lemeritur, filluan të largoheshin nga trojet e shtëpitë e tyre si rezultat i sulmeve sistematike, i vrasjeve masive deri në krijimin e varreve të përbashkëta nga pushkatimet në masë e krimet e tjera që vetëm serbët dinë t'i bëjnë. Synimi i serbëve tashmë u kuptua qartë nga mbarë opinioni ndërkombëtar:

Fshirja e historisë, pastrimi etnik në Kosovë!

Luftimet në Kosovë, në vitin 1998, sollën më vonë zhvendosjen me forcë, me armë e me krime të më se 500.000 shqiptarëve kosovarë. Në këto momente, kur jeta e një shqiptari në Kosovë nuk kishte asnjëfarë vlere, Organizata e Kombeve të Bashkuara vendosi embargon e armëve ndaj Beogradit. Në të njëjtën kohë, në Prishtinë filluan demonstratat antiserbe, kundër dhunës, kundër vrasjeve. Në muajin shtator të vitit 1998, kriminelin Millosheviq pranoi deri në njëfarë mase një autonomi të cunguar, që kurrë nuk u fitua për Kosovën. Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kërkonte në mënyrë urgjente armëpushimin, tërheqjen e forcave militare dhe paramilitare serbe nga territori shqiptar në Kosovë, si dhe fillimin e menjëhershëm të negociatave politike, diplomatike e të bisedimeve.

Gjatë muajit tetor, nën kërcënimin e sulmeve ajrore të forcave paqeruajtëse të NATO-s, Millosheviqi pranoi tërheqjen e trupave ushtarake e policore nga Kosova, ndërprejten e dhunës dhe vendosjen e një force prej 2.000 vetash (Misioni i Verifikimit në Kosovë), nën mandatin e OSBE-së. Por, antishqiptari më i keq i këtij fundshekulli, Slobodan Milosheviqi, nuk do ta mbante kurrë fjalën e dhënë.

Si rezultat i krimeve të vazhdueshme ndaj shqiptarëve nga makina luftarake e qeverisë serbe në agoni, nga forca të ndryshme të armatosura, të ushtrisë, të policisë, të kriminelëve të marrë me pagesë, në muajin dhjetor të vitit 1998, shpërtheu një luftë e përgjithshme ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ushtrisë, policisë dhe mercenarëve serbë.

Grupi i Kontaktit, i 6 shteteve, i themeluar në Konferencën e Londrës më 1992, u mblodh më 29 janar 1999. Në këtë takim u ra dakord që të fillonin negociatat urgjente ndërmjet palëve në konflikt, të monitoruara nga ndërkombëtarët. NATO—ja mbështeti dhe përforcoi përpjekjet e Grupit të Kontaktit, duke rënë dakord që të përdoren sulmet ajrore në qoftë se do të kërkohej një diçka e tillë. Në të njëjtën kohë, NATO—ja mori përsipër përgjegjësinë që të realizonte mbikëqyrjen e të dy palëve në luftë.

Fillimisht, këto konsiderohen si iniciativa. Por, ato arritën kulmin e tyre me fillimin e negociatave në Rambuje, afër Parisit, nga data 6 shkurt 1999 deri më 23 shkurt 1999, të pasuara dhe nga një raund i dytë në Paris ndërmjet datave 15–18 mars 1999. Në përfundim të raundit të dytë të bisedimeve në Paris, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës firmosi marrëveshjen e propozuar të paqes, në Rambuje.

Por, më vonë, bisedimet u ndërpre në pa asnjë nënshkrim të delegacionit serb. Raundi i dytë i bisedimeve në Rambuje bëri që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të pranohet si palë në marrëveshje, duke përfshirë tërheqjen e forcave serbe, një autonomi me bazë të gjerë për Kosovën, duke i hapur rrugë një referendumit për pavarësinë dhe vendosjen e një force ushtarake multinacionale prej 30.000 vetash. Sigurisht, që këtë arsyetim të marrëveshjes, Slllobodan Milosheviqi nuk do ta pranonte kurrë.

Gjatë muajit mars të vitit 1999, forcat ushtarake, kryesisht ato ajrore të NATO—s, filluan fushatën e sulmeve ajrore kundër forcave ushtarake serbe. Kjo fushatë e sulmeve ajrore zgjati deri në 77 ditë pothuajse pa ndërprerje.

Më 10 qershor 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO—s, Javier Solana, tha se kishte udhëzuar gjeneralin e famshëm Uesli Klark për

t'i ndërprerë përkohësisht sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë. Ky vendim u mor pas një konsultimi të gjerë me Këshillin e Atlantikut Verior, si dhe pas konfirmimit nga gjenerali Klark se kishte filluar tërheqja e ushtrisë jugosllave nga territori shqiptar i Kosovës.

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara konfirmoi përfundimin e luftës dhe vendosjen e një operacioni ushtarak force paqeruajtëse të udhëhequr e të drejtuar nga NATO-ja, i koduar me emrin KFOR, si dhe të një misioni civil të udhëhequr e të drejtuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të koduar me emrin UNMIK.

Kosova, që nga ky moment fitoi pavarësinë e përjetshme!

DR. SAI T SAI T

Sekretar i Përgjithshëm i Kryqit të Kuq në Maqedoninë e Veriut

PËRGJIGJJA HUMANITARE E KRYQIT TË KUQ GJATË KRIZËS KOSOVARE

Fillimi i krizës humanitare për ne nisi që në muajin gusht të vitit 1998, kur në lokalet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë (KKRM) dhe Delegacionit të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (FNKKGJK) për Mbështetje dhe Ndihmë, u paraqitën para së gjithash gra me fëmijë, të moshuar të pafuqishëm, dhe persona me nevoja të veçanta, numri i të cilëve në këtë periudhë (gusht–dhjetor 1998) arriti në 800 persona të regjistruar. Në fakt, këta njerëz ishin në njëfarë mënyre pararendësja e një vale të madhe refugjatësh në fillim të vitit 1999 (400.000) të cilët edhe në atë periudhë nuk janë ndjerë të sigurt në Kosovë. Kjo është koha kur nisi të shfaqet vetëm fillimi i krizës më të madhe të refugjatëve në vendin tonë. Këta njerëz sipas misionit të Kryqit të kuq u regjistruan vetëm në bazën e të dhënave të KKRM–së dhe ata morën ndihmë humanitare sipas vlerësimit nga ana e ekipeve mobile. Këta njerëz u akomoduan në strehim privat tek të afërmit dhe miqtë e tyre.

Me vetë fillimin në vitin 1999, numri i njerëzve të paraqitur për ndihmë dhe mbështetje në zyrat e Kryqit të kuq është rritur nga dita të ditë deri në momentin kur ka arritur kulmin me valën e madhe në kalimin kufitar Bllacë dhe Jazhincë. Nga ai moment Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) merr përsipër regjistrimin e këtyre njerëzve me status të personave të kujdesur humanitarë nga

njëra anë, dhe Kryqi i kuq nga ana tjetër, kur janë regjistruar personat që kanë nevojë për mbështetje humanitare, mjekësore dhe psikologjike, dhe në të njëjtën kohë është aktivizuar gjithashtu Shërbimi i kërkimit (bashkimi i familjeve). Numri gjithsej i personave që kanë marrë mbështetje nga ana e Kryqit të kuq gjatë Krizës kosovare (të akomoduar në strehim privat dhe në kampe) ishte 440.000 persona. Numri gjithsej i refugjatëve që braktisën Kosovën në rajon arriti në 920.000 njerëz.

FILLIMI I KRIZËS

Kryqi i Kuq i RM-së, fillimin e krizës kosovare në njëfarë mënyre e nisi me një mbështetje të pamasë nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe e cila Delegacionin e saj e hapi në vitin 1992 me valën e parë të refugjatëve nga Bosnja (Delegacioni u mbyll në prill të vitit 2003) dhe Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq (KNKK) i cili arriti në Maqedoni në vitin 1993 (Delegacioni mbylli zyrën në vitin 2008).

Në pajtim me Marrëveshjen e Seviljes ku u përcaktuan rolet e tre komponentëve të Lëvizjes në kohë krize, FNKKGJK—ja në mënyrë të plotë ishte e obliguar për të ndërtuar kapacitetet e Shoqatës nacionale për ballafaqim me krizën (regjistrimin e personave për ndihmë, shpërndarjen e ndihmave humanitare, ndihmën psikosociale dhe mjekësore, koordinimin e ndihmës që arriti nga shumë vende) dhe nga ana tjetër FNKK—ja kishte detyrë për të koordinuar Shërbimin e kërkimit dhe për të dhënë mbështetje për aktivitetet që janë koordinuar nga ana e FNKKGJK.

Gjatë kohës së krizës kosovare për të mbështetur vendin tonë, në RM zyrat e tyre i hapën edhe: Kryqi i kuq i Gjermanisë, Kryqi i kuq i Finlandës, Kryqi i kuq i SHBA-së, Kryqi i kuq i Spanjës,

Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë, Gjysmëhëna e kuqe e Kuvajtit dhe në këtë mënyrë u tregua dhe u dëshmuua fuqia e humanizmit dhe mënyra e shpejtë e mobilizimit brenda Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Të përbërë nga vullnetarë dhe punonjës, ekipet e Kryqit të kuq filluan aktivitetet e tyre qysh në kalimet kufitare (shpërndarja e produkteve ushqimore bazë dhe ujit, transportimi i kategorive të prekshme të personave, pikat e Shërbimit të kërkitimit). Personat që u regjistruan për ndihmë u akomoduan në vendbanimet me tenda (Stenkovec, Bojanë, Çegran), në kampet Radushë, Katllanovë, Qendrën e Kryqit të kuq “Dare Bombol” Vodno, Qendrën e Kryqit të kuq Strugë, Pushimoren e fëmijëve Lubanci, Çiçino Sello, Shuto Orizarë dhe në familje private (60% të numrit të përgjithshëm të personave të regjistruar). Kryqi i kuq realizoi aktivitetet e tij në të gjitha qendrat kolektive, por është e nevojshme të theksojmë se ndihma për personat e strehimit privat në vend u koordinua vetëm nga ana e Qendrës informative të Kryqit të kuq.

Gjatë kohës së krizës koordinimi i gjithmbarshëm i ndihmës humanitare nga organizatat tjera ndërkombëtare, organizatat joqeveritare që kishin programet e tyre dedikuar për këta persona kryhej nga KKKRM–ja dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, mbështetur nga FNKKKGJK–ja. E gjithë kjo tregon kapacitetin e Kryqit të kuq për ndërtimin e lidhjeve operative të veprimit në terren. Gjatë kohës së krizës u aktivizuan plotësisht të gjitha 34 organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, por përqindja më e madhe e personave u akomoduan në Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe Gostivar.

Në nivel të shtetit menjëherë u formua Shtabi i Krizës me vendimin e Qeverisë së RM–së me qëllim të koordinimit të situatës në

vend. Ky shtab përbëhej nga përfaqësues të këtyre ministrive dhe organizatave:

- 1) Ministria e Mbrojtjes;
- (2) Ministria e Punëve të Brendshme;
- (3) Ministria e Transportit dhe Lidhjeve;
- (4) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- (5) Ministria e Punëve të Jashtme;
- (6) Ministria e Shëndetësisë;
- (7) NATO;
- (8) Komisariati i Lartë i Refugjatëve (UNHCR);
- (9) Kryqi i kuq i RM-së.

Obligimet e përditshme të këtij shtabi si një Trup koordinues qeveritar ishin si vijon:

- (1) të mbledh dhe verifikon informacione;
- (2) të informojë Kryetarin, Kryeministrin dhe Qeverinë për informacionin e marrë në terren;
- (3) të përgatisë vendime që duhet t'i miratojë Këshilli i Sigurisë;
- (4) të koordinojë operacionet;
- (5) të sigurojë strehim dhe mbrojtje për refugjatët;

Gjatë kohës së krizës komunikimi me organizatat e KB-ve në vend (UNHCR, UNICEF, IOM, Programi Botëror i Ushqimit) si dhe organizatat tjera lokale dhe ndërkombëtare (Karitas, Ambasada e Fëmijëve, El Hilal etj.) ishte në nivel të shkëlqyer gjë që reduktoi mundësitë për t'u mbuluar me njëra-tjetrën aktivitetet në terren.

AKTIVITETET TONA

Formimi i ekipeve – Ekipet formohen në 24 orët e para në përputhje me nevojat në terren dhe ato janë të përbëra nga vullnetarët e KK-së që kanë përfunduar trajnimin e vlerësimit, logjistikës dhe ndihmës së parë, duke u mbështetur nga shërbimet profesionale. Aktivitetet fillestare të këtyre ekipeve janë realizuar në kalimet kufitare për të mbështetur personat që kanë nevojë për ndihmë dhe strehim, si dhe shpërndarja e produkteve ushqimore kryesore dhe ujit. Ekipet e Kryqit të kuq ishin të obliguara për transportimin e kategorive të prekshme të personave, të cilët kishin nevojë për strehim emergjent ose transportim për në spital.

Hapja e pikave të Shërbimit të kërkimit – Gjatë kohës së luftës, migrimeve dhe krizave të refugjatëve më së shumti vuan familja, më saktë ndërpritet lidhja ndërmjet anëtarëve. Për këtë qëllim Shërbimi i kërkimit ka numrin më të madh të intervenimeve në periudhën pasi të jetë kapërcyer periudha fillestare e shokut dhe traumës.

Gjatë kohës së Krizës kosovare u mbledhën gjithsej 6946 porosi, 5475 prej tyre u shpërndanë, ndërsa 1361 porosi u kthyen tek dërguesit. 968 emra të personave janë publikuar në radio dhe janë mundësuar 5949 lajmërimi telefonike. Janë regjistruar gjithsej 400 fëmijë pa shoqërues, janë hapur 1670 kërkesa për gjetjen e familjeve të fëmijëve pa shoqërues, janë bashkuar 734 familje dhe 209 persona kanë marrë dokumente të identifikimit. Deri në përfundim të vitit 2004 të gjitha rastet e hapura të lidhura me këtë krizë janë mbyllur. Shërbimi i kërkimit është koordinuar nga ana e KNKK-së në gjithë territorin e vendit, dhe vullnetarët e trajnuar të KK-së

ishin pjesë e ekipeve që ishin të obliguara për porositë dedikuar familjeve të refugjatëve.

Regjistrimi i personave për shpërndarjen e ndihmës humanitare – Gjatë kohës së krizës Kryqi i kuq ishte i obliguar për regjistrimin e personave që kishin nevojë për ushqim, higjienë, pako për foshnja, pelena për fëmijë dhe të rritur dhe ndihma tjera materiale (veshje, batanije etj.). Shpërndarja e kësaj ndihme është organizuar përmes magazinave në të gjitha 35 degët e Kryqit të kuq anembanë vendit. Paketat janë shpërndarë në përputhje me normativat e përgatitura paraprakisht për familjet e refugjatëve në bazë mujore.

Gjithashtu Kryqi i kuq ishte i obliguar për të hartuar bazën e të dhënave të personave shtetas të RM-së që kanë pritur refugjatë në shtëpitë e tyre. Mbështetja për këto familje përbëhej nga shpërndarja e ndihmës humanitare në çdo të dytin muaj. Nga numri i përgjithshëm i personave që u strehuan në RM, 60% prej tyre ishin pjesë e strehimit privat, ndërsa shpërndarja e ndihmës për personat e strehuar në kampet organizohej përmes drejtorisë së vetë kampeve. Ekipet e obliguara për këtë aktivitet gjithashtu në bazë mujore përgatitnin raporte për shpërndarjen.

Menaxhimi i qendrave kolektive – Prej gjithsej 11 kampeve që kanë funksionuar gjatë kohës së krizës, Kryqi i kuq ishte i obliguar për të menaxhuar 4 prej tyre. Përgjegjësia e ekipeve në këto kampe ishte organizimi dhe koordinimi i plotë i aktiviteteve të karakterit social, shëndetësor, arsimor për personat e akomoduar në to.

Aktivitetet psikosociale – Këto aktivitete u krijuan për grupe të veçanta të kategorive të prekshme të personave (nëna kujdestare, persona të moshuar, persona me nevoja të veçanta, jetimë) por gjithashtu edhe për persona të moshuar që kishin nevojë për ndihmë

të specializuar nga ana e psikologëve dhe neuropsikiatërve për kapërcimin e krizës mentale të personalitetit.

Aktivitetet shëndetësore parandaluese – Vullnetarët e Kryqit të kuq që janë pjesë e aktiviteteve shëndetësore parandaluese të Kryqit të kuq ishin të obliguar për të zbatuar aktivitetet me qëllim për të shmangur paraqitjen e ndonjë sëmundje infektuese dhe për të parandaluar epideminë e saj.

Mbrojtja shëndetësore dhe shpërndarja e barnave – Brenda kampeve (Stenkovec, Çegran dhe Bojanë) funksiononin edhe spitale në terren të Kryqit të kuq të Gjermanisë, Kryqit të kuq të Norvegjisë dhe Gjysmëhënës së kuqe të Turqisë.

Ekipet e specializuara mjekësore punonin në këto spitale dhe ishin të obliguara për mbrojtjen e plotë primare dhe sekondare të personave të strehuar në kampet. Personeli është mbështetur në mënyrë logjistike nga ana e vullnetarëve të KKRМ-së për të funksionuar në mënyrë të pandërprerë spitale. Ato kishin në dispozicion salla të operacionit, sallë lindjeje, ordinancë stomatologjike dhe një pjesë për akomodimin e pacientëve. Brenda spitaleve funksiononin edhe stacionet për pastrimin e ujit. Një stacion i tillë i është dhuruar Kryqit të kuq të RМ-së, dhe ai funksionon në kuadër të Njësisë për reagim në katastrofa të KKRМ-së.

Koordinimi i ndihmës humanitare – Gjatë Krizës kosovare në Maqedoni pati një fluks të ndihmës humanitare në sasi të mëdha. Për shkak të efikasitetit më të madh dhe shpërndarjes së saj, Kryqi i kuq mori përsipër rolin e koordinimit.

Në këtë mënyrë u konfirmua roli i Shoqatës nacionale në cilësinë e ndihmës të Qeverisë dhe institucioneve shtetërore. Për shkak të

rrjetit të mirë të resurseve materiale dhe njerëzore, Kryqi i kuq drejtonte ndihmën tek përdoruesit finalë.

Logjistika dhe puna e magazinave – Shpërndarja e ndihmës humanitare është realizuar nga tre Magazina qendrore (Shkup, Veles dhe Ohër). Së këtejmi në përputhje me raportet për numrin e personave të akomoduar në qytete të ndryshme të vendit dhe kampet ajo u shpërnda tek zyrat lokale të Kryqit të kuq.

Aktivitetet për arsimimin dhe rekreacionin e personave të vendosur në kampe – Për shkak të përmirësimit të gjendjes psikosociale si dhe integrimin në sistemin arsimor, në vendin pritës organizohen aktivitete për arsim dhe rekreacion.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me komitetet e refugjatëve – Për të bërë një vlerësim më të mirë të nevojave të refugjatëve dhe dëshirës për mbështetje dhe ndihmë, Kryqi i kuq organizoi aktivitetin për formimin e komiteteve të refugjatëve në kampe. Në këtë mënyrë komunikimi me përdoruesit u lehtësua, gjë që rezultoi me një punë më efikase në terren.

Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve të zyrave lokale të Kryqit të kuq – Janë organizuar trajnime shtesë të shërbimeve profesionale dhe vullnetarëve si dhe është dhënë mbështetje në resurset materiale–teknike.

Funksionimi i Qendrës informative të Kryqit të kuq – Gjatë krizës rolin më të madh në komunikimin me personat e vendosur në familjet private e luajti Qendra informative e Kryqit të kuq, e cila për herë të parë u hap gjatë Krizës së Bosnjës. Përmes kësaj qendre në mënyrë efikase dhe efektive u realizuan aktivitetet dedikuar për personat që ishin vendosur në shtëpi private.

Organizimi i grupeve për të shkuar në vende të treta dhe riatdhesimi vullnetar – Bëhet vlerësimi i personave të kategorive të prekshme që kanë nevojë për shërbime shtesë në vende të tjera si dhe marrja e aktiviteteve për kthim vullnetar në vendin e origjinës.

Organizimi i programit dedikuar për familjet e rrezikuara në aspekt social të shtetasve të RM-së – Për të ulur tensionin në vend nga numri i madh i refugjatëve që ishin vendosur dhe që merrnin ndihmë të rregullt humanitare në bazë mujore, Kryqi i kuq në bashkëpunim me Komisionin evropian për operacione humanitare (ECHO) dhe organizata të tjera humanitare që kishin zyrat e tyre në vendin tonë, filloi programin për shpërndarjen e paketave sociale për shtetasit tanë të regjistruar në qendrat e punës sociale. Programi u realizua deri në fund të vitit 2002.

ANALIZA E PËRGJIGJES

Si një nga aktorët kryesorë në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të Krizës kosovare, puna e Kryqit të kuq ishte pjesë e aktiviteteve të gjithmbarshme për zbatimin e aranzhmaneve, masave dhe procedurave me qëllim:

- (1) të vihet kriza nën kontroll;
- (2) të mundësohen përgatitje për një përgjigje më gjithëpërfshirëse ndaj sfidave të ardhshme.

Por, për fat të keq duhet të konstatojmë se ekzistonin një sërë dobësish dhe një mosgatishmëri e caktuar për shkak të intensitetit të madh të krizës. Kjo dobësi u mund me ndihmën dhe mbështetjen që mbërriti nga ana e komponentëve të Lëvizjes (FNKKGJK, KNKK) dhe shoqatave të tjera nacionale anëtare të Lëvizjes. Evaluimin e përgjigjes, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë e bënte

në bashkëpunim me përfaqësuesit e FNKKGJK, KNKK dhe Shoqatat nacionale, institucionet e sistemit (Qeveria, Ministritë, Agjencitë) dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe lokale.

Qëllimi i këtyre analizave ishte që Kryqi i kuq i RM-së të përpunojë leksionet e mësuara nga përvoja me Krizën kosovare për të mundësuar një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë në situata të ardhshme eventuale të krizës. Analizat konfirmuan faktin se krizat e ndërlikuara si Kriza kosovare nuk njohin kufij nacionalë dhe po qe se ato nuk menaxhohen në mënyrë efektive dhe të koordinuar, ato mund të ndikojnë në sigurinë dhe stabilitetin e një vendi të caktuar, po ashtu edhe të rajonit, në rastin tonë të Ballkanit.

Këto analiza të Kryqit të kuq të RM-së në bazë të përvojave të veta të lidhura me pjesëmarrjen në formë të mbështetjes së Krizës kosovare të refugjatëve zhvilluan zgjidhjet e ardhshme konceptuale dhe strategjike në dokumentet e KK-së (nacionale dhe ndërkombëtare) për reagim dhe veprim në rast të katastrofave dhe situatave të krizës. U zhvillua një vegël e dobishme për Lëvizjen ndërkombëtare të KK-së me qëllim që të ndihmohet në drejtimin e përgjigjeve të ardhshme ndaj ngjarjeve të këtilla të ndërlikuara ose situatave të jashtëzakonshme.

Nga analiza u nxorën mësimet, por edhe rekomandimet e mëposhtme:

- Si përgjigje e krizave të ndërlikuara, sa të jetë e mundur më herët duhet të përcaktohet qasja strategjike drejt planifikimit të resurseve materiale-teknike dhe njerëzore në bazë të bashkëpunimit me komponentët e lëvizjes dhe partnerët tjerë;
- Përmirësimi i bashkëpunimit të shoqatave nacionale të rajonit përmes angazhimit të tyre aktiv, rishikimi i kërcënimeve të

përbashkëta dhe përcaktimi i një përgjigje të organizuar ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve;

- Përcaktimi i procedurave operative standarde që do të implemtohen në shoqatat nacionale duke mundësuar me këtë rast një bashkëpunim më të rrjedhshëm dhe më efikas;
- Lehtësimi dhe harmonizimi i procedurave doganore si parakusht për sigurimin e ndihmës humanitare efikase dhe në kohën e duhur;
- Avancimi i mëtejshëm i menaxhimentit vullnetar si parakusht për një realizim të suksesshëm të aktiviteteve në terren;
- Sigurimi i rezervave minimale të mallrave (ushqim, higjienë, batanije, tenda) si garanci për përgjigjen fillestare deri në aktivizimin e planit për një përgjigje gjithëpërfshirëse në katastrofa;
- Ngritja e nivelit të transparencës së punës dhe avancimi i sistemit informativ dhe marrëdhëniet me publikun.

LEKSIONET E MËSUARA

- Koordinimi maksimal ndërmjet sektorit civil dhe qeveritar që në fazën e planifikimit;
- Një komplet i harmonizuar i procedurave të koordinimit dhe bashkëpunimit në bazë të standardeve ndërkombëtare, që duhet të vendoset qysh në fazën më të hershme;
- Qasja strategjike (ndarja e drejtë e roleve) ndaj planifikimit të situatave të krizës duhet të jetë bazuar në përfshirjen e plotë dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët në operacion (shoqatat nacionale, institucionet qeveritare, komponentët e Lëvizjes së KK-së dhe organizatat tjera lokale dhe ndërkombëtare);

- Krijimi i programeve të mbështetjes në përputhje me vlerësimin e nevojave të përdoruesve finalë;
- Të përdoren të gjitha mundësitë për mobilizimin e vullnetarëve/burimeve njerëzore;
- Përmirësimi i iniciativave promovuese – promovimi i punës së përbashkët;
- Eliminimi i ndikimit negativ të konkurrueshmërisë në shoqërinë civile dhe promovimi i praktikave pozitive të bashkëpunimit;
- Përcaktimi më i mirë i termit popullsi e prekshme;
- Duke pasur parasysh se këto hapësira shpeshherë janë ekspozuar ndaj katastrofave natyrore dhe katastrofave të shkaktuara nga njeriu imponohet nevoja për të marrë masa të rritura për përmirësimin e programeve të gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa;
- Vendosija e një sistemi për paralajmërim të hershëm;
- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet agjencive;685
- Shënimi i duhur i vullnetarëve të Kryqit të kuq gjatë kohës së aktivitetit në terren;
- Ngritja e nivelit të monitorimit në aktivitetet në terren.

AKTIVITETET E KRYQIT TË KUQ PAS KRIZËS

Vala e madhe e refugjatëve që ndodhi në fillim të vitit 1999 dhe akomodimi i më shumë se 400.000 njerëzve, si dhe aktivitetet që u realizuan në 6 muajt e parë të vitit 1999 mund t'i definojmë si një përgjigje emergjente ndaj krizës për përmbushjen e nevojave të popullsisë së prekshme. Në verën e vitit 1999 pjesa më e madhe e

personave u kthyen në shtëpitë e tyre ose shkuan në vende të treta. 30% e refugjatëve kryesisht romë, goranë, serbë, mbetën në Maqedoni edhe në periudhën e ardhshme deri në gjetjen e zgjidhjes për riatdhesimin e tyre. Kryqi i kuq i RM-së edhe më tej vazhdon të kujdeset për këta persona duke vazhduar aktivitetet për mbështetjen e tyre. Për momentin në RM si pasojë e Krizës kosovare ka edhe 1500 persona (99% romë) që akoma nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre, ndërsa 700 persona kanë aplikuar për integrim në vendin tonë dhe ata pritet të jenë të integruar.

Kryqi i kuq në bashkëpunim me UNHCR-në ka zhvilluar Programin për logjistikë dhe mbështetje mjekësore të këtyre personave, si dhe Qendrën për mbështetjen e arsimit dhe bashkësinë e refugjatëve dhe kërkuesit e azilit në RMV.

RISHIKIMI I DIPLOMACISË HUMANITARE NË KONTEKST TË LËVIZJES SË KRYQIT TË KUQ

Në vitet e fundit termi diplomaci humanitare ka hyrë në përdorim të përditshëm në shprehjen e organizatave humanitare, si dhe brenda Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Megjithatë vetë ideja “diplomaci humanitare” nuk është jo kontestuese, vetë ajo si koncept ka një natyrë jo precize deri diku kontestuese të termit, si dhe paraqitja e saj në një zbatim jo të qartë operativ. Prandaj ekzistojnë shumë definicione për vëllimin e aktiviteteve të diplomacisë humanitare, si dhe disa sfida me të cilat ajo përballlet. Një nga qëllimet kryesore të diplomacisë humanitare është të bind vendimmarrësit dhe publikun për të vepruar në interes të grupeve të prekshme dhe për të siguruar respektim të plotë të parimeve humanitare themelore.

Përgjegjësia për bindjen dhe lobimin e suksesshëm çon drejt të praktikuarit të veglave dhe aktiviteteve të reja përkatëse si dhe forcimin e kapaciteteve me qëllim të mobilizimit të gjitha resurseve relevante, si dhe sigurimin e partneriteteve efektive si pjesë e hapave të një diplomacie efektive humanitare. Në këtë kontekst diplomacia humanitare është e re dhe definicioni i saj nuk i përgjigjet asaj të diplomacisë konvencionale, qëllimi i së cilës është ballafaqimi me marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve përmes negociatave. Në vend të kësaj, diplomacia humanitare fokusohet në maksimizimin e mbështetjes së operacioneve dhe programeve, si dhe ndërtimin e partneriteteve të domosdoshme për qëllimet humanitare që duhet të arrihen.

Në kuadër të këtij punimi u tregua vendosja, komponentët dhe statusi juridik i Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Në kuadër të këtij titulli me rëndësi është të përmendet se në vitin 1994, FNKKGJK–ja nga ana e KB–së me Rezolutën 49/2 është pranuar si vëzhguese. Në këtë kuptim ajo trajtohet së bashku me agjencitë e specializuara të KB–ve dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Ky status siguron qasje në politikat dhe procesin e vendimmarrjes në nivel ndërkombëtar dhe lokal.

Strategjia 2020 e FNKKGJK–së e miratuar nga ana e Kuvendit të Përgjithshëm në vitin 2009 përcakton diplomacinë humanitare si “aksion i volitshëm për të arritur qëllimet e veta”. Sipas Siddhart Chatterjee, diplomacia humanitare e FNKKGJK–së përfaqëson “ndikimin e vendimmarrësve dhe mendimet e liderëve për të vepruar në interes të grupeve të prekshme të popullsisë, dhe me respektim të plotë të parimeve themelore humanitare”. Ajo fton të

gjithë për të bërë më shumë, më mirë dhe të gjithë së bashku të arrijnë më larg me ndihmën e diplomacisë humanitare.

Ekzistojnë disa fusha të cilat në Lëvizjen konsiderohen si prioritet i diplomacisë humanitare që përshin: avokimin e komunikimeve dhe partneriteteve. Diplomacia humanitare e zbatuar në mënyrë efikase duhet të bind qeveritë, organizatat, grupet e biznesit, komunitetet, lidershipin dhe publikun për të vepruar ndryshe, të ndryshojnë dhe në njëfarë mënyrë të drejtojnë politikën e tyre për një zhvillim të mëtejshëm të qëndrueshëm në:

- (1) shëndet për të gjithë dhe mjedis të shëndetshëm jetësor;
- (2) gatishmëri përkatëse për katastrofat;
- (3) përmbushje të nevojave themelore dhe avancim të respektimit të ndryshueshmërisë;
- (4) inkurajim të demokracisë;
- (5) pjesëmarrje dhe përfshirje të qytetarëve në procesin e vendim-marrjes;
- (6) ndërtim të shoqërisë me një zhvillim të qëndrueshëm përfshirës;
- (7) ulje të varfërisë;
- (8) kujdes për njeriun;
- (9) mundësim të mirëqenies për komunitetet;
- (10) sundim të mirë përmes zhvillimit të kapaciteteve për institucione efektive;
- (11) pjesëmarrje të komuniteteve në dizajnimin e agjendës nacionale për përgjigje ndaj kërcënimeve të ndryshimeve klimatike dhe

pjesëmarrje të komuniteteve lokale në konceptimin, planifikimin dhe kryerjen e politikave të qëndrueshme.

Diplomacia humanitare është determinuar nga paraqitja dhe historia e aksionit humanitar dhe tërheq “raison d’etre”—n e saj nga përpjekjet e bëra nga ana punonjësve humanitarë në nivel ndërkombëtar, nacional dhe lokal duke u përpjekur për të lejuar qasjen për tek personat që kanë nevojë për ndihmë. Në pajtim me mandatin e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq, diplomacia humanitare konsiston kryesisht në kujdesin dhe nevojat e viktimave të konflikteve të armatosura, në negociatat për marrëveshje humanitare me aktorët ndërkombëtarë ose nacionalë, në cilësinë e një ndërmjetësuesi neutral ndërmjet tyre dhe në ndihmën për të përgatitur dhe siguruar respekt për të drejtën humanitare. Diplomacia humanitare përmes avokimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik i drejtohet një spektri të gjerë të aktorëve nacionalë dhe ndërkombëtarë të cilët shpesh janë larg dhe të pandërgjegjshëm për nevojën e ndihmës humanitare. Përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin për problemet në krizat humanitare janë orientuar drejt palëve dhe vendeve përgjegjëse për situatën, si dhe drejt aktorëve të shoqërisë civile.

Është i nevojshëm një bashkëpunim i vazhdueshëm me qeveritë për të arritur kushte të volitshme të punës së shoqatave nacionale, për shkak se në situata të krizës qeveritë bëhen më të arritshme dhe më dashamirëse. Në një situatë të tillë metodat e diplomacisë humanitare duhet të zbatohen në dobi të shoqatës nacionale dhe vendit. Për të pasur rezultat është e nevojshme të zbatohen metodat e diplomacisë humanitare në nivel lokal d.m.th. **AKSIONI HUMANITAR + DIPLOMACIA = REZULTATI.**

Diplomacia humanitare është po aq e rëndësishme edhe në kontekst të parandalimit të rrezikut edhe në menaxhimin e krizave dhe

situatave të konfliktit. Ajo inkorporohet në përpjekjet e reja të KB-ve dhe vendeve anëtare për të investuar në aksionin parandalues. Ajo është në funksion të idesë për të investuar një shumë relativisht modeste të fondeve për të parandaluar një konflikt të dhunshëm në vend se të investohet në proceset humanitare, paqësore, rindërtuese ose në operacionet e stabilizimit. Në këtë drejtim diplomacia humanitare merr kuptimin praktik në botën që po përballet me një ngetje të stuhishme ekonomike të zhvillimit ekonomik.⁶⁹⁰ Ajo përmes mekanizmave avokativë luan rol të rëndësishëm në vendosjen e një veprimi të përbashkët në situata emergjente nga ana e të gjithë aktorëve dhe faktorëve relevantë.

DR. ZEQRIRJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të
Shqiptarëve—Shkup*

NË KUFIRIN E JETËS★

Shënimi i 20–vjetorit të ngjarjes së eksodit të shqiptarëve nga Kosova përbën në vetvete një freski të kujtesës kolektive dhe ua kujton atë tragjedi edhe shqiptarëve të sotëm, që mund ta kenë qitur mendsh ose që në atë kohë kanë qenë fare të rinj dhe nuk e dinë se çfarë ka qenë realisht ajo ngjarje.

Pas fillimit të sulmeve të NATO–s ndaj caqeve serbe, që nisëm më 24 mars 1999 (dhe zgjatën deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor të atij viti), Serbia e filloi spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës. Kështu, përveç dhunës sistematike ndër vite, që e kishte ushtruar shteti serb, me vrasje, masakra, përdhunime e shkatërrim të pronës private, për më pak se dy javë të pranverës së vitit 1999 përzuri me dhunë nga shtëpitë tyre më shumë se 1 milion shqiptarë të Kosovës (këtë togfjalësh do ta përdorim qëllimisht disa herë në tekst, për shkak të rëndësisë historike që e ka), të cilët u drejtuan në kufirin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë. Dhe, siç dihet, derisa Shqipëria – me gjithë gjenden e rënduar ekonomike dhe problemet e tjera – i hapi dyert dhe i pranoi, duke krijuar “qyteza me refugjatë”, Maqedonia – për shkak të drojës së prishjes së balancës etnike, por edhe për shkak të drojës së mospërballimit të krizës, refugjatët e ardhur i ndaloj në zonën ndërmjetkufitare në Bllacë dhe nuk lejoi që ata të futen në Maqedoni derisa të zgjidhej problemi i menaxhimit të asaj situatë. Prandaj, për një javë rresht, gati 400 mijë njerëz mbetën në qiell të hapur në motin e ftohtë të

pranverës së hershme, në shi, me kushte të vështira higjienike dhe pa ushqim të mjaftueshëm.

Spastrimi etnik

Pasi që kanë kaluar 20 vjet dhe shumë gjëra janë rrafshuar, ndërsa Kosova vazhdon të mbetet shtet i kontestuar, madje Serbia edhe sot synon të marrë territor Kosovë – shpesh edhe me mbështetje ndërkombëtare, është e rendit të themi se pas 25 marsit të vitit 1999 Serbia dëboi me dhunë nga shtëpitë e tyre më shumë se 1 milion shqiptarë. Kjo fjali duhet të përsëritet në secilën konferencë ndërkombëtare për Kosovën dhe duhet të shkruhet në secilën pritje të zyrtarëve të kancelarive perëndimore, që në emër të paqes, integritetit dhe bashkëekzistencës, vijnë të kërkojnë akoma koncesione nga kosovarët.

1 milion e më shumë shqiptarë të Kosovës u dëbuan me dhunë nga shteti serb, por askush deri më sot nuk ka kërkuar falje për këtë spastrim etnik dhe askush nuk është gjykuar nga asnjë gjykatë ndërkombëtare që ka dhënë urdhër për këtë spastrim etnik.

Natyrisht, as shteti serb nuk ka marrë asnjë dënim për këtë krim. Ndërkaq, të urdhërosh spastrim etnik në oborr të Europës dhe në kapërcyell të shekujve XX me XXI, kjo do të duhej të ishte kryetitulli i shkëljes së të drejtave të njeriut i të gjitha organizatave vendore e ndërkombëtare që merren me këto çështje. Nëse dihet se synimi i shtetit serb të asaj kohe ishte që Kosovën ta zbrazë tërësisht nga shqiptarët dhe kështu ta realizojë planin e elaborateve famëkeqe serbe për një Kosovë me pakicë shqiptare, i bie se kemi pasur të bëjmë me një regjim shfarosës dhe fashizoid kundrejt shqiptarëve dhe me një plan të paramenduar për zhbërje. Derisa hebrenjtë e gjithë Europës i drejtonin në Aushvic a në kampet e tjera të

holokaustit në vitet e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1999 një shtet me emrin Republika e Serbisë, nën drejtimin e një njeriu me emrin Slobodan Millosheviq, më shumë se 1 milion shqiptarë për disa javë i përzuri nga shtëpitë e veta, duke i shtyrë drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë. Dallimi i vetëm është se Gjermania, ndonëse ka kërkuar falje, edhe sot i paguan dëmet ndaj hebrenjve, ndërsa Republika e Serbisë nuk e pranon këtë faj dhe këtë spastrim etnik, nuk kërkon falje, madje kërkon akoma koncesione, bile edhe territor, nga shqiptarët e Kosovës. Dhe, ndonëse për holokaustin ndaj hebrenjve thuaja të gjithë në Europë janë të pajtimt dhe e gjykojnë njëzëri nazizmin e Hitlerit, Europa heziton që ta ndëshkojë Serbinë për këtë faj dhe, bile, e merr me t'mirë “për interesa gjeopolitike”.

Sidoqoftë, kjo nuk e lëkund të vërtetën se pas 25 marsit 1999 Republika e Serbisë i ka përzënë dhunshëm nga shtëpitë e tyre më shumë 1 milion shqiptarë nga Kosova, ndërsa gjatë kësaj lufte i ka vrarë më shumë se 10 mijë civilë shqiptarë të Kosovës, i ka përdhunuuar rreth 20 mijë gra shqiptare të Kosovës – shpesh duke i poshtëruar në sy të familjarëve të tyre, ka kryer disa masakra me përmasa gjenocidi, si ajo e Reçakut, e Krushës së Madhe, Studimes etj. etj., për të cilat u trazua dhe u trondit gjithë bota, dhe në truallin e saj mban akoma më shumë 1.600 të pagjetur, të cilët nuk kanë as varr.

Këto janë shifrat që duhet ndërmendur sa herë që shqiptarët e Kosovës takohen me zyrtarë të Serbisë, por edhe me zyrtarë të tjerë ndërkombëtarë perëndimorë, madje vetëm pasi të përsëriten ato fjali, mund të flitet për tema të tjera.

Solidarizimi i shqiptarëve të Maqedonisë

Një gjë që është thënë e që është mirë të rithuhet për gjeneratat e reja, është solidarizimi i shqiptarëve të Maqedonisë në atë tragjedi.

Derisa shqiptarët e Kosovës mbaheshin “të burgosur” në “kufirin e jetës” në Bllacë, shqiptarët e Maqedonisë ishin të gjithë në këmbë. Ato ditë të gjithë ishin në lëvizje – secili duke kërkuar një mënyrë që të ndihmojë.

Kam pasur mundësinë, që si aktivist i Kryqit të Kuq, por edhe i organizatave të tjera humanitare, ta ndjej për së afërmi këtë solidarizim dhe sakrificë. Pasi që Maqedonia e hapi kufirin, te shqiptarët e Maqedonisë filloi një lloj gare se kush merr më shumë refugjatë. Ata filluan ta ndjejnë një dozë turpi nëse dikush nuk kishte refugjatë të Kosovës në shtëpinë e vet. Ishin mbresëlënëse rastet kur edhe familje të varfra mblidheshin vet në një dhomë të vogël dhe pjesën tjetër të shtëpisë ua linin vëllezërve të tyre kosovarë. Kjo ngjarje ka qenë një dëshmi se shqiptarët e kanë të zhvilluar deri në maksimum instinktin e mbijetesës dhe akoma e kanë të fuqishme në memorien e tyre kolektive maksimën kanunore se “shtëpia është e mikut dhe e Zotit”.

Jam i mendimit se, përkundër asaj që mund të duket jomodeste, sepse askush nuk e ka bërë këtë sakrificë për famë, megjithatë aktualizimi i saj dhe vlerësimi i saj në kushtet tona, do të ishte jo vetëm mirënjohje për shqiptarët e Maqedonisë, por do të ishte edhe një edukim për gjeneratat e reja me këtë virtyt. Është kjo një vlerë që duhet të mbahet dhe të kultivohet. Madje, përveç kësaj, përsëritja e këtyre rrëfimeve, që mund të jenë material i mirë edhe për vepra artistike, është një mënyrë e mirë për ta mbajtur gjallë edhe vëllazërinë ndërshtepetare. Gjeneratat e reja, që jetojnë me këta kufij, përmes kësaj ngjarje dhe shembujve ilustrues të atij solidarizimi, duhet ta ruajnë kujtesën e përbashkët se jemi një komb, që jetojmë në disa shtete në Ballkan, porse kur jemi pranë

zhbërjes, ne jemi një qenie. Kjo detyrimisht ndihmon në lidhjen vëllazërore të shqiptarëve mes vete.

Dhe, e fundit, ky solidarizim do të ishte edhe një vlerësim nga shqiptarët e tjerë, të Kosovës e të Shqipërisë, por edhe të mërgatës, se te shqiptarët e Maqedonisë ruhet fuqishëm identiteti kombëtar dhe solidarizimi me pjesët e tjera të kombit. Rrëfimet pranverës së vitit 1999 dëshmojnë se shqiptarët e Maqedonisë e kanë ruajtur shpirtin primordial shqiptar dhe, përkundër trysnive dhe presioneve të ndryshme politike e të tjera, kanë mbetur shqiptarët mbase më autentikë që i ka shqiptaria. Vlerësimi i këtillë nuk përbën mburrje në kuptim të krekosjes, por përbën mburrje se edhe shqiptarët janë pjesë e rëndësishme e kombit dhe se ata – njësoj si krejt shqiptarët e tjerë – vuajnë e festojnë shqip.

Instituti në shërbim të kujtesës kolektive

Duke qenë institucioni i vetëm shkencor që, profesionalisht, kujdeset për mbrojtjen e trashëgimisë, kulturës, historisë, gjuhës e letërsisë shqiptare, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – përveç detyrimeve të tjera të përditshme – ka ngritur edhe nismën për krijimin e një qendre përkujtimore në kufirin Maqedoni e Veriut – Kosovë. Ky propozim është dorëzuar në qeverinë e Republikë së Kosovës, prej së cilës ka marrë edhe miratim, si dhe në qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej ku po ashtu pritet mbështetje.

Instituti, përmes departamentit të Muzeologjisë, synon që kjo qendër përkujtimore të jetë një “Yad Vashem i shqiptarëve” të gjithë botës, por edhe mirënjohje për gjithë botën e qytetëruar, që më 1999 ndërhyri për shpëtimin e kombit shqiptar të Kosovës.

Më tej, ideja e Institutit është që ngjarja e Bllacës së vitit 1999 të jetë një pikë që do ta ndërtojë kauzën e ardhshme të shqiptarëve të këtyre trojeve. Përveç rikujtimit të ngjarjes së vitit '99, në atë qendër do të duhej të mbledhej gjithë materiali arkivor i dhunës sistematike të pushteteve të ndryshme serbe ndaj shqiptarëve, për të qenë kështu një rrëfim dinjitoz për vuajtjet njëshekullore të shqiptarëve për mbijetesë. Sipas Institutit, Bllaca e vitit 1999 është stacioni i fundit i kësaj fushate sistematike për shfarosjen e shqiptarëve dhe, duke qenë pikë kufitare, është sinonim i kalimit nga vdekja në jetë. Përveç kësaj, ajo do të shënonte edhe pikëlidhjen dhe pikëtakimin mes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, si peng i ndihmës së ndërsjellë dhe marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore.

Katarza, kërkimfalja dhe kujtesa

Shënimi i këtij 20-vjetori të ngjarjes së Bllacës, që vjen bashkë me nismën për këtë qendër përkujtimore të eksodit ose gjenocidit ndaj shqiptarëve, i ka në vetë tri momente që ia vlen të merren parasysh edhe si konkluzion.

Është fillimisht katarza e shqiptarëve, sepse në atë qendër do të akumuloheshin të gjitha rrëfimet, të gjithë lotët dhe të gjitha përpjekjet për mbijetesë. Kjo qendër do të ishte një mundësi katarze edhe për pushtetarët e sotëm serbë, që do të duhej të vijnë e të përkulen aty, duke kërkuar falje për krejt ato dëme që pushtetet e kaluara serbe ua kanë bërë shqiptarëve dhe duke e çliruar edhe kombin e tyre nga barra e fajit ndaj fqinjëve të tyre. Kjo kërkimfalje, pra, do të ishte një mundësi e mirë që shqiptarët e serbët të mund të ndërtojnë një të ardhme tjetër mes vete, duke e kujtuar bashkërisht të kaluarën, duke marrë mësim prej saj dhe duke synuar një të ardhme të përbashkët europiane të pajtimit, bashkëjetesës dhe fqinjësisë së mirë.

III.

PROMOVIMI I LIBRIT
“BLLACA, DHIMBJA E LIRISË”

SHKUP – PRISHTINË

**NË SHKUP U PROMOVUA LIBRI:
“BLLACA, DHIMBJA E LIRISË”
– EMIN AZEMI**

Shkup, 12 prill 2019 – Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup, u promovua libri i autorit Emin Azemi me titull “Bllaca, dhimbja e lirisë”, në kujtim të 20–vjetorit të eksodit kosovar.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se ky libër vjen në kohën e duhur, për të argumentuar një pjesë të rëndësishme të memories tonë kolektive, e cila çdo ditë e më tepër po rrezikon të venitet.

Për librin folën edhe recensentët Resul Shabani dhe Sevdail Demiri, ndërsa fjalë përshëndetëse patën ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj, dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Hysen Matoshi.

Ndërsa, autori Emin Azemi theksoi se libri është i konceptuar si kronikë kujtimesh personale, dhe i kombinuar me kontribute të autorëve të tjerë, që asokohe ishin botuar në gazetën e përditshme të FAKTI. Libri përmban një kronikë të gjatë të ngjarjeve që lidhen me eksodin e para 20 viteve, që filloi qysh nga marsi i 1999–tës. Në shiritin e kujtesës së autorit kanë ngelur shumë detaje, rrëfime, imazhe, e mbi të gjitha shumë fytyra pleqsh të shqetësuar, tronditje grash e fëmijësh të trishtuar, dhe shumë të humbur e të hutuar në labirintin e ferrit të Bllacës, aty ku gjatë ditëve të ftohta të mars/prillit 1999 po vihej në skenë një prej tragjediave më makabre të njerëzimit.

Botimi i Institutit “Bllaca, dhimbja e lirisë”, me autor Emin Azemi, pritet të promovohet edhe në Prishtinë dhe Tiranë.



Pamje nga promovini në Shkup



DR. SEVDAIL DEMIRI

ITSHKSH – Shkup

NJË VEPËR PËR BLLACËN ‘99, ARGUMENT PËR EKSODIN DHE SPASTRIMIN ETNIK TË KOSOVËS

*(Disa fjalë rreth librit “Bllaca, dhimbja e lirisë” – të autorit
Emin Azemi, botues ITSHKSH–Shkup, 2019, fq.342)*

Jemi të lumtur që këtë 20–vjetor të luftës, eksodit dhe çlirimit të Kosovës nga pushtuesi serb, po e kurorëzojmë me një vepër konkrete dhe njaft argumentuese, me librin e autorit të njohur Emin Azemi, me titull “Dhimbja e lirisë”!

Në të vërtetë, ky është projekti i dytë i rëndësishëm tematik, që Instituti jonë po e promovon, pas Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit “Bllacë 99”, gjë që neve na bën të ndihemi pak më komod në raport me kohën dhe përgjegjësitë që na takojnë si institucion dhe si shoqëri.

Dy dekada më parë, Kosova u gjend para sprovës së madhe të mbi-jetesës! Shumica shqiptare iu nënshtrua dhunës dhe aparteidit me përmasa genocidale, që po ushtronte makineria vrastare serbe e Sllobodan Millosheviqit. Rezistenca pasive dhjetëvjeçare, tanimë ishte kthyer në një vullkan aktiv liridashës me në krye Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Masakrat që po bënte pushteti serb i kohës kundër shqiptarëve, kishte mbushur kupën, dhe Aleanca Veriatlantike shtypi sustën e intervenimit ushtarak mbi caqet e zullumit. Në fundmarsin e vitit 1999, me avionët që po bombardonin caqet

serbe, brenda Kosovës po zhvillohej një tragjedi e paparë në fund-shekullin 20. Regjimi serb i kohës, duke nxjerrë grahamat e fundit, po bende kërdoi mbi popullsinë civile të pambrojtur shqiptare. Filloi një kalvar vuajtjesh për gati gjysmën e popullsisë së Kosovës. Plani gjenocidal “Patkoi”, kishte për qëllim spastrimin etnik të Kosovës, duke i nxjerrë shqiptarët e saj jashtë, kryesisht në drejtim të Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Në këtë pikë, përqendrohet syzheu i librit “Bllaca, dhimbja e lirisë”, i cili vjen para lexuesit mu në kohën e duhur, për të na rikujtuar, jo vetëm vuajtjet dhe sakrificën sublime të mijëra shqiptarëve të shpërngulur dhunshëm nga trojet e veta 20 vjet më parë, por edhe solidarizimin e miliona shqiptarëve të tjerë me këtë tragjedi kolektive!

Libri në fjalë përmban kryesisht tekste autoriale të gazetarit dhe botuesit të njohur, Emin Azemi, i cili me pendën e tij shigjetonte problemet e krizës kosovare. Sidomos, editorialet dhe reportazhet nga ferri i Bllacës, në të cilat faktet nga terreni aq bukur gërshetohen me elemente dhe figura letrare, e bëjnë librin mjaft të këndshëm për lexim. Në të hasim edhe një numër simbolik të teksteve tematike të autorëve tjerë, të cilat kanë pasur kuptim dhe ndikim në opinionin e gjerë publik në kohën kur janë publikuar.

Materialet e këtij libri flasin për vuajtjet e të dëbuarve, bashkë me rrëfimet e tyre për dhunën dhe masakrat e kryera ndaj civilëve, flasin për ndihmën e pakursyer të shqiptarëve të këtushëm, shoqatave të shumta humanitare, por edhe ngathtësinë e institucioneve qeveritare maqedonase, të cilat për një javë rresht krijuan kordon të hekurt për të penguar hyrjen e të dëbuarve këndeje kufirit.

Në këtë libër del në pah shpirti i madh human i shqiptarit të Maqedonisë, i cili me ditë e javë të tëra, pareshtur u qëndronte pranë vëllezërve të tyre të gjakut nëpër kampet e njerimit. Del në pah edhe ndjeshmëria e botës perëndimore, me në krye SHBA—në, e cila ia ndali hovin Serbisë dhe parandaloi aktin e turpërimit të civilizimit modern.

Ky libër është i shoqëruar edhe me një numër të madh të fotografive, të cilat e plotësojnë mozaikun e ngjarjeve dramatike, jo vetëm se të tre muajve të ferrit të Bllacës, por edhe të radhëve të tjerë të ferrit nëpër kampet e Stenkovecit, Neproshtenit, Radushës, Bojanës. Bllaca është metafora e të gjitha dhimbjeve, e cila solli në jetë lirinë e shumëpritur të Kosovës.

Arsenali kryesor i teksteve të botuara në këtë libër, është pjesë e një mjeti të fuqishëm mediatik të kohës për të cilën po flasim, të të përditshmes informative FAKTI, si gazeta e parë e pavarur në gjuhën shqipe në Maqedoni. Për luftën çlirimtare dhe krizën humanitare të Kosovës, gazeta FAKTI në Shkup, ishte një nga burimet kryesore, jo vetëm se të opinionit vendor, por edhe atij ndërkombëtar.

Andaj, me të drejtë, autori Azemi, në një rast do të konstatojë se, ‘bashkë me të ikurit nga Kosova, ato ditë të vështira, në Maqedoni kishin ardhur edhe gazetarë të huaj, të cilët raportonin mbi atë që ndodhte. Disa prej tyre kishin zgjedhur redaksinë e gazetës FAKTI për të raportuar në Berlin, Londër, Paris, Uashington. Ndërsa Tetova, Kumanova e Shkupi ishin bërë epiqendra të këtyre kronikave gazetareske’.

Ne si shqiptarë deri më tani nuk kemi arritur të argumentojmë as minimumin e fakteve për luftën e drejtë çlirimtare të UÇK—së. Në

anën tjetër, Serbia për luftën e saj të padrejtë në Kosovë ka bërë dhjetëfishin e botimeve vendore dhe ndërkombëtare, me argumente të rreme. Për këtë flasin edhe gjyqet e njëpasnjëshme që zhvillohen në Prishtinë e Hagë kundër luftëtarëve të UÇK-së, derisa për krimet serbe flitet gjithnjë e më pak! Parë në këtë kontekst, libri i Emin Azemit “Bllaca, dhimbja e lirisë”, është një kontribut tepër domethënës në rrafsh kombëtar dhe ndërkombëtar, për argumentimin e eksodit dhe tendencave antinjerëzore serbe për spastrimin etnik të Kosovës.

Shkup, 12.04.2019

Prishtinë, 21.06.2019

DY PROJEKTET TEMATIKE PËR BLLACËN, U PROMOVUAN NË PRISHTINË

Prishtinë, 21.06.2019 – Në sallën e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup, duke iu bashkëngjitur aktiviteteve për shënimin e 20–vjetorit të luftës, eksodit dhe çlirimit të Kosovës, promovoi dy projekte të rëndësishme tematike: librin e Emin Azemit “Bllaca – Dhimbja e lirisë”, dhe elaboratin e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit “Bllacë 99”.

Në emër të Institutit, foli historiani dhe publicisti Sevdail Demiri, i cili në cilësinë e recensentit tha se materialet e këtij libri flasin për vuajtjet e të dëbuarve, bashkë me rrëfimet e tyre për dhunën dhe masakrat e kryera ndaj civilëve, flasin për ndihmën e pakursyer të shqiptarëve të këtushëm, shoqatave të shumta humanitare. “Arsenali kryesor i teksteve të botuara në këtë libër, është pjesë e një mjeti të fuqishëm mediatik të kohës për të cilën po flasim, të të përditshmes informative FAKTI, si gazeta e parë e pavarur në gjuhën shqipe në Maqedoni. Për luftën çlirimtare dhe krizën humanitare nëpër të cilën kaluan vëllezërit nga Kosova, gazeta FAKTI në Shkup, ishte një nga burimet kryesore, jo vetëm se të opinionit vendor, por edhe atij ndërkombëtar”, tha Demiri.

Profesori i komunikimit, Arben Fetoshi u shpreh se dimensionin më të rëndësishëm, ose vlera e parë e librit, është ‘memorizimi’ i fakteve për një pjesë të historisë tonë, që shërben po ashtu si burim i sistemuar për studiuesit shqiptarë në të ardhmen. Ndërsa, gazetari Arben Veselaj tha se ky libër përmbledh shkrimet për vuajtjet e të zhvendosurve shqiptarë në disa kampe.

Autori i librit, Emin Azemi tha se ky libër është një përmbledhje e aktakuzave që do të duhej të procedoheshin nga dikush në mënyrë që gjenocidi serb të marr dënimin e duhur.

Kryetari i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve në trojet e veta, Jahja Llluka, foli në veçanti për elaboratin e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit “Bllacë 99”, si një projekt i përbashkët me Institutin, i cili mëton të lidhë historinë shqiptare në të dyja anët e kufirit.



Paneli gjatë përrurimit të dy edicioneve të Institutit në Prishtinë



IV.

ELABORATI:

QENDRA PËRKUJTIMORE E GJENOCIDIT “BLLACË 1999”

SFONDI HISTORIK

Me ndryshimet kushtuese të imponuara nga Serbia, më 23 mars 1989 në Kuvendin Krahinës së Kosovës do të ndryshojë edhe Kushtetuta e vitit 1974, me çka u suprimua autonomia e Kosovës në Federatën e Jugosllavisë, duke e shndërruar Kosovën në pjesë përbërëse të Serbisë. Pas kësaj filloi një presion ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, e cila ishte e detyruar të tërhiqet nga të gjitha

institucionet dhe të vetorganizohen në të gjitha fushat e jetës shoqërore politike. Kështu, më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës e shpalli Deklaratën Kushtetuese, që e definonte Kosovën si Republikë. Deklarata e Pavarësisë u pasua me nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 7 shtator të vitit 1990 në Kaçanik. Më pas, me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, Kosova e organizoi edhe referendumin për pavarësi e sovranitet, të mbajtur në shtatorin e vitit 1991. Nga ky moment, në Kosovë u instalua sistemi i organizimit paralel, që pasoi me zgjedhjet e mbajtura jashtë sistemit juridik jugosllav ose, më saktë, serb.

Dhjetë vitet e kësaj gjendjeje (1989–1999) lanë pasoja të rënda për jetën e njerëzve me persekutime, burgosje, maltretime, por lanë pasoja edhe mbi arsimin, shkencën, kulturën, sportin etj. Gjatë kësaj kohe shqiptarët e mërgatës ishin ata që, duke mbledhur fonde, u munduan ta mbajnë gjallë arsimin, por edhe institucionet paralele shtetërore.

Si rezultat i kësaj gjendjeje, erdhi deri te organizimi ushtarak i shqiptarëve të Kosovës, që nënkuptonte edhe reagimin e shtetit të atëhershëm jugosllav. Kështu më 5 mars të vitit 1998 forcat serbe e sulmojnë fshatin Prekaz i Poshtëm, ku e vrasin Adem Jasharin bashkë me 20 anëtarë të familjes së tij (10 prej të cilëve fëmijë), ndërsa numri i përgjithshëm i të vrarëve shqiptarë në atë aksion ishte 55 njerëz.

Kështu edhe filloi rezistenca e armatosur, që erdhi deri në masakrën e Reçakut më 15 janar 1999, kur forcat serbe vranë 45 civilë shqiptarë, që u raportua nga Shefi i Misionit Mbikëqyrës të atëhershëm të OSBE-së në Kosovë. Pas kësaj vijuan sulmet e NATO-s mbi caqet serbe, që filluan më 24 mars 1999 dhe zgjatën 78 ditë. Më 9 qershor 1999 në Kumanovë u nënshkrua marrëveshja

ndërmjet NATO-s dhe RSFJ-së, që nënkuptonte largimin e ushtrisë jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e forcave të NATO-s, të quajtura KFOR.

Sipas raportimeve të bëra, gjatë këtij konflikti luftarak janë vrarë 13.549 persona, prej tyre 76 % civilë, ndërsa 24% kanë qenë pjesëtarë të forcave të armatosura. 1.400 viktima kanë qenë të moshës nën 18 vjeç.

Gjatë kësaj kohe, përveç veprimeve luftarake, ajo që pësoi më së shumti ishte popullata civile. Sipas raportit të Kryqit të Kuq të Maqedonisë, që e ka ndjekur gjithë situatën në atë kohë, gjatë vitit 1998 – për shkak të veprimeve luftarake, në Maqedoni ishin vendosur 800 refugjatë. Kjo situatë ishte e menaxhueshme derisa ishte në këto shifra.

Por, kur filluan sulmet e NATO-s në Serbi dhe në pika të tjera ushtrisë jugosllave në Kosovë, gjendja u bë shumë e vështirë për popullatën civile. Prandaj pranvera e vitit 1999 ishte vala më e madhe e refugjatëve në Maqedoni. Sipas Kryqit të Kuq, ky numër për një javë u rrit në 400.000 sosh, që ishte një krizë e papërballueshme për Maqedoninë. Kështu, derisa Maqedonia po merrej me organizimin e pritjes së valës së refugjatëve, nga 31 marsi deri më 6 prill 1999 në pikën kufitare të Bllacës, në territorin

e Maqedonisë, qëndruan disa qindra mijë kosovarë, të ardhur me tren, me makina, por edhe në këmbë, që qëndruan aty disa ditë derisa u zgjidh çështja e kampeve të refugjatë brenda vendit dhe transportimi i tyre në vende të treta. Ato ishin ditë të rënda, sepse qindra mijëra njerëz u desh t'i kalojnë netët në qiell të hapur. Prandaj, për shkak të motit të ligë, mungesës së ushqimeve (edhe pse aktivistët humanitarë dhe bamirësit ndihmonin me sa fuqi kishin), u

shënuan dhjetëra vdekje, veçanërisht të fëmijëve dhe mbetën trauma të pashlyeshme për ata njerëz. Kjo zgjati derisa Republika e Maqedonisë gjeti mundësitë dhe krijoi kapacitete që t'i pranojë këta refugjatë, për çka u angazhua gjithë bota e qytetëruar. Por, Bllaca mbeti sinonim i Holokaustit për shqiptarët, që gjatë asaj jave të valës së refugjatëve mbetën në qiell të hapur, duke u përpjekur ta shpëtojnë ekzistencën e tyre. Ngjashëm me rrëfimin biblik të Eksodit.

Sipas asaj që shkruhet në të dhënat e Kryqit të Kuq, nga Kosova janë deportuar gjithsej 920.000 persona, ndërsa në Maqedoni gjatë gjithë krizës janë vendosur diku 440.000 refugjatë. Për këtë arsye, atëbotë në Maqedoni u ndërtuan disa lagje/kampe të përkohshme për refugjatë, si në: Stenkovec, Radushë, Çegran, Neproshten, Katllanovë, Dare Bomboll – Vodno, Strugë, Lubancë, Çiçino Sello, Shuto Orizarë, që u ngritën në tenda me ndihmë të organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Vetëm gjatë kësaj kohe në zbutjen e kësaj krize ndihmuan Kryqi i Kuq i Gjermanisë, Kryqi i Kuq i Finlandës, Kryqi i Kuq i Spanjës, Kryqi i Kuq i SHBA-ve, Gjysmëhëna e Turqisë, Gjysmëhëna e Kuvajtit, “Mjekët pa kufi” etj.

Gjatë dhe pas vendosjes së refugjatëve nëpër kampe janë regjistruar 400 fëmijë të humbur, që është dashur të bashkohen me familjet e tyre, ndërsa janë regjistruar edhe 1.670 kërkesa për gjetje të familjeve, nga të cilat 734 kanë rezultuar me sukses. Përveç vendosjes në kampe të refugjatëve, atëbotë është shënuar një solidarizim i paparë nga popullata në Maqedoni, e cila gati 60% të refugjatëve i mori në shtëpi private.

Kriza e refugjatëve përfundoi në verën e vitit 1999, pas futjes së NATO-s në Kosovë, kur shumica e tyre u kthyen në vatrat e tyre.

QENDRA PËRKUJTIMORE NË FRYMË TË KOHEZIONIT

Për Republikën e Kosovës ngjarja e krejt luftës së viteve 1998–1999 dhe, sidomos, kriza e refugjatëve, që metaforizohet në javën e qëndrimit në golgotën e Bllacës, është pjesë e pandashme e ndërtimit të shtetit të Kosovës dhe prandaj duhet një konservim i kujtesës kolektive historike për gjeneratat e reja dhe për opinionin botëror. Ndërsa për Maqedoninë kjo ngjarje është shenjë e një shteti fqinj, që ato ditë të rënda, si “miku i mirë në ditë të vështirë”, iu gjet pranë fqinjit të saj. Kjo është shkak që kjo histori të përjetësohet përmes një qendre përkujtimore, që do ta shënonte këtë dramë, ndërsa ngritja e saj do të ishte mirë të bëhej pikërisht në 20-vjetorin e ngjarjes (prill 2019).

Përveç kësaj, për Republikën e Maqedonisë kjo qendër do të ishte simbol i ndihmës, bamirësisë, solidaritetit dhe sakrificës jo vetëm në ditët e Bllacës, por gjatë gjithë krizës së refugjatëve në Maqedoni dhe do të ishte një imazh i mirë i vendit se si dhe sa ka ndihmuar në atë katastrofë humanitare. Të kujtojmë këtu se sa është e rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare të dëshmohet se cilat vende dhe kombe kanë ndihmuar në shpëtimin e hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore. Në këtë drejtim, Maqedonisë do i atribuohet epiteti i vendit që ka qenë shkaktari kryesor i shpëtimit të jetës së gati gjysmë milioni njerëz dhe kjo është një meritë jo e vogël në arenën ndërkombëtare. Përveç kësaj, kjo do të ishte edhe një peng i marrëdhënieve të mira shqiptaromaqedonase, gjegjësisht kosovare–maqedonase, që flet se këta dy popuj dhe shtete në momente kritike janë ndihmuar mes vete, që për gjeneratat e reja do të ishte mesazh për kohezion dhe bashkëjetesë ndërfqinjësore.

Ndërkaq, për Republikën e Kosovës, një qendër përkujtimore në Bllacë do të ishte një metaforë e përpjekjes së shqiptarëve për liri, e

vuajtjeve dhe e sakrificës, që për gjeneratat e reja do të ishte një “Jad Vashem” i holokaustit, eksodit dhe kalvarit nëpër të cilin ka kaluar popullata e Kosovës në kapërcyell të shekujve.

Natyrisht, duke pasur parasysh kontekstin e ri euro-atlantik, kjo qendër nuk do të duhej të shërbente për të hapur plagë të vjetra dhe urrejtje, por më shumë për të tërhequr vëmendjen se për sa pak kohë dhe shkujdesje ka nevojë krini, që t’i rikthejë panjet e holokaustit të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë drejtim qendra nuk duhet për shërbejë për të ndërtuar akuza ndaj ndonjë kombi sot, sepse tashmë jemi në një kontekst tjetër historik dhe politik, ku i gjithë rajoni ka synime euro-integruese dhe kur kjo e kaluar ka mbetur si kujtim i hidhur. Bile, kjo qendër mund të ishte edhe pika e kërkimflajes dhe pajtimit mes kombeve ballkanike, në këtë rast mes shqiptarëve dhe serbëve, siç ndodhi para do kohe me përkuljen e presidentit serb në Srebrenicë.

EMËRTIMI

Propozimi jonë është që emri i kësaj pike përkujtimore të jetë “Qendra Përkujtimore e Gjenocidit Bllacë 1999”.

E kemi lënë emërtimin “qendër” për disa arsye:

- 1) synojmë të jetë qendër e pelegrinazhit shqiptar;
- 2) synojmë të jetë më shumë se muze; dhe
- 3) qendra do të nënkuptonte jo diçka periferike, por një bërthamë.

Pjesa “përkujtimore” është në fakt shqipërimi i mbiemrit “memoriale”, sepse ajo e ka rolin pikërisht të ruajtjes së kujtesës kolektive për një histori të kaluar.

E kemi quajtur “e Gjenocidit”, sepse për shqiptarët e Kosovës përzënia e 1 milion njerëzve nga trojet e veta, vrasja ose masakrimi i

mbi 13 mijë civilëve shqiptarë dhe dhunimi i disa mijëra grave, ka qenë një përpjekje për shfarosje totale, e ngjashme me atë që e bënë nazistët ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore.

Dhe, e kemi lënë “Bllacë 1999”, duke që synuar këtë emërtim ta bëjmë metaforë të vuajtjeve të shqiptarëve, sepse edhe si e tillë ajo tashmë në diskursin publik funksionon për këtë qëllim.

KUFIRI

Idea e jonë është që në pikën kufitare Bllacë, në anën e lumit Lepenc, të ngrihet një qendër përkujtimore për ngjarjen e refugjatëve në Bllacë, si dhe e pranisë së refugjatëve në kampet e refugjatëve në Maqedoni, por edhe në shtëpi private.

Vendosja e qendrës në kufi është edhe me një çelës i marrëdhënieve të mira të Maqedonisë dhe Kosovës, por edhe çelës i dëshmisë se ky kufi dikur ka qenë vija e ndarjes së jetës dhe vdekjes. Kalimi i këtij kufiri dikur ka shënuar shpëtimin. Ndërkaq,

sot me menaxhimin e përbashkët të kufijve, me kalimin e kufirit me letërnjoftime, si dhe me synimin e liberalizimit të kufijve brenda BE-së, ky kufi do të jetë një relik i së kaluarës së këtyre popujve dhe shteteve.

PËRSHKRIMI FIZIK

Kjo qendër përkujtimore, që do të ishte e vendosur në një hapësirë, relativisht, modeste fizike, do të duhej të kishte edhe një ndërtesë modeste dhe të bukur. Qendra duhet të përbëhet nga dy pjesë: muzeu dhe obelisku.

Në pjesën e muzeut duhet të mbliidhen të gjitha materialet që kanë mbetur nga ajo kohë, që e shënojnë atë ngjarje. Para së gjithash këtu duhet të vendoset një vagon i trenit që atëherë i ka prurë refugjatë në Bllacë, aty duhet të ketë ekspozitë të përhershme me fotografi, video–xhirime dhe gjësende të asaj kohe, që mund të shërbejnë për ta krijuar atmosferën e fillim–prillit të vitit 1999. Ndonëse është detyrë e arkitektëve, propozimi jonë është që vetë shtëpia të ishte një objekt që e krijon atmosferën e atyre momenteve.

Përveç pjesës së muzeut, propozojmë që aty të ndërtohet një obelisk i gjatë (të hapet konkurs për realizim artistik), që e tërheq vëmendjen e kalimtarëve dhe që do të jetë përmendorja ku do të kujtohet kjo ngjarje famëkeqe. Përreth obeliskut do të ishte mirë të rregullohet një park me lule e me flamurë të Maqedonisë e të Kosovës, që do të jetë “parku i miqësisë” ndërshtetërore.

DEPARTAMENTET DHE VEPRIMTARITË

Që kjo qendër përkujtimore të mund të funksionojë si qendrat më bashkëkohore përkujtimore, ajo duhet t’i ketë në vete disa departamente që mund të ushtrojnë disa veprimtari të ndryshme:

1. Arkivi

Arkivi është pika që i mbledhë të gjithë materialet dhe gjësendet që kanë lidhje me historinë në fjalë. Në arkiv ruhen edhe origjinalet e të gjitha dokumenteve, fotografive dhe video–materialeve që i takon Qendrës dhe që kanë të bëjnë me historinë e saj. Gjithashtu Arkivi e ruan edhe administratën e Qendrës, të dhënat për numrin e vizitorëve, për vendet nga të cilat është vizituar qendra etj. Këto me kalimin e kohës bëhen të dhëna shumë të rëndësishme në promovimin e kësaj qendre në botë.

2. Muzeu

Muzeu është pjesa qendrore e Qendrës. Në të janë të përfshirë këto elemente:

- Hapësirë për ekspozimin e të gjitha materialeve autentike të konservuara ngangjarja e prillit të vitit 1999 (treni, veshje, orendi, ambalazhe etj.)

- Hapësirë për ekspozitë të përhershme – për këtë duhet një hapësirë pak më e madhe, sepse aty do të duhej të ekspozoheshin shumë fotografi dhe materiale të tjera, si dokumente, që janë të rëndësishme për Qendrën. Kjo kërkon një zgjidhje artistike që secilin vizitor e fut në atmosferën e ngjarjes përkatëse historike. Në kuadër të kësaj hapësire do të ishte mirë që fundi i vizitës së fotografive të kulminojë me një emision të shkurtër dokumentar (5–10 min) për ngjarjen në fjalë.

- Hapësirë për ekspozita dokumentare dhe artistike – në këtë hapësirë është menduar që autorë të huaj, që nuk janë të punësuar në Qendër, por që kanë materiale për historinë e kësaj ngjarje, të mund t’i ekspozojnë ato në periudha të ndryshme kohore. Në këtë hapësirë mund të ekspozohen edhe punime të tjera artistike që kanë të bëjnë me temën e Qendrës, por edhe të organizohen koloni artistike etj.

3. Instituti

Një departament i veçantë i Qendrës do të ishte krijimi i një instituti hulumtues shkencor, që ka për qëllim vetëm hulumtimin e të dhënave mbi historinë e fillim–prillit 1999 në Bllacë, për luftën e viteve 1998–1999, për të gjitha vuajtjet e shkaktuara nga ai konflikt, për kampet e refugjatëve në Maqedoni, për historitë

familjare të refugjatëve etj. Ky institut mund të bëhet një pikë e referencës shkencore përkritazi me këtë ngjarje.

Në këtë institut do të ishin të angazhuar historianë, mjekë, sociologë, psikologë e artistë. Këta hulumtues, sipas natyrës së punës – përveç hulumtimit, do të duhet të marrin pjesë në sa shumë konferenca shkencore, që tema e ngjarjes së prillit të Bllacës 1999 të ndërkombëtarizohet sa më shumë dhe të kalojë në stad të studimit shkencor.

Një veprimtari tjetër e Institutit duhet të jetë edhe edukimi. Me qëllim që gjeneratat e reja të njihen me këtë ngjarje, Instituti do të duhet të organizojë edhe kurse dhe vizita informative nëpër shkolla dhe nëpër universitete.

“Edukimi për gjenocidin ndaj shqiptarëve” do të duhej të përfshijë edhe shkolla verore, ndërsa – bashke me Institutin e Qendrës – duhet të organizojnë "Studime për gjenocidin ndaj shqiptarëve", që mund të jenë specializime ose studime master, në mënyrë që kjo temë të trajtohet në nivele akademike.

Përveç kësaj, Instituti – në emër të Qendrës – duhet të bëjë edhe botime të librave për fëmijë dhe për të rritur me këtë histori dhe këto të jenë botime sa më shumë të shpërndara nëpër të gjitha gjuhët e botës.

Një veprimtari tjetër e Institutit duhet të jetë edhe organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve shkencore. Një cikël ligjëratah nëpër shkolla, disa tribuna shkencore gjatë vitit ose disa debate për temën e ngjarjes së prillit të vitit 1999 në Bllacë, janë mjete me të cilët animohet edhe pjesa tjetër e opinionit që ta kuptojë rëndësinë e kësaj teme dhe të jetë më shumë e interesuar për të.

Ndërkaq simpoziumet dhe konferencat serioze shkencore, së paku një e tillë në vit me studiues të vendit dhe të huaj, do të ishin mënyra më qëlluar e studimit dhe promovimit të kësaj historie.

4. Biblioteka

Një Qendre të përmasave të këtilla i duhet detyrimisht edhe një bibliotekë, e cila do ta mbledhë gjithë literaturën e shkruar në çfarëdo gjuhe për këtë ngjarje, madje edhe botimet e gazetave dhe raportimet e organizatave humanitare të kohës, që kanë bërë fjalë përkitazi me këtë ngjarje.

Kjo bibliotekë do të jetë epiqendra e gjithë literaturës në të gjitha gjuhët përkitazi me këtë çështje. Për këtë qëllim ajo duhet të vendosë kontakt me të gjitha bibliotekat nacionale të rajonit dhe me sa më shumë biblioteka të institucioneve shkencore e arsimore të vendeve të botës, për ta mbledhë në një pikë gjithë këtë literaturë. Në këtë mënyrë biblioteka e Qendrës Përkujtimore të Gjenocidit "Bllacë 1999" do të jetë strumbullari i të gjitha punimeve shkencore që do të shkruhen mbi këtë histori.

5. Digjitalizimi dhe promovimi

Duke qenë pjesë e një botë digjitale, të gjitha materialet dhe aktivitetet e Qendrës do të duhet të promovohen në platformat e ndryshme të internetit, ndërsa të gjitha materialet e shtypura do të duhet të digjitalizohen dhe të prezantohen në ueb-faqen e Qendrës dhe në platformat e tjera elektronike, duke krijuar një korpus elektronik të kësaj historie.

Në kuadër të kësaj veprimtarie bie edhe përgatitja e video-materialeve, që do të jenë si filma dokumentarë, filma të metrazhit të shkurtër, video nga arkiva etj.

6. Ngjarje dhe fushata sensibilizmi për paqe

Qendra duhet të organizojë edhe ngjarje dhe aktivitete të tjera, që mund të jenë mënyrë e sensibilimit të historisë së trajtuar nga ajo ose të vetë qendrës.

Një marsh nga Prishtina ose Shkupi deri në Bllacë, një maratonë, një garë me biçikleta, një turne në ndonjë sport, një koloni artistike ose një garë në projekte filmike të kësaj teme, janë mënyra të qëlluara që edhe ngjarja historike të përkujtohet, por edhe që të afirmohet puna e Qendrës.

Në këtë drejtim, një veprimtari e veçantë e Qendrës do të ishte një fushatë e saj “Për paqe dhe pajtim”, që do të duhej të shtrihet dhe propagandohet në të gjitha vendet e rajonit, kjo duke e marrë si shembull këtë ngjarje për të mësuar se sa është e rëndësishme paqja për jetën e njerëzve.

7. Këndi i falënderimit dhe përkujtimit

Në Qendër do të duhej të bëhet edhe një “Kënd i falënderimit”, ku do të shkruheshin emrat e të gjithë politikanëve të huaj e vendorë, organizatave dhe personaliteteve të tjera që kanë ndihmuar në zbutjen e kësaj tragjediehumanitare. Mund të ketë foto nga vizita e Presidentit Clinton (dhe të tjerëve) në kampin “Stenkovec” etj.

Ndërkaq edhe “Fletorja e kujtimeve”, ku do t’i shkruajnë kujtimet e tyre vizitorët e qendrës mund të jetë një burim i rëndësishëm jo vetëm për ta vlerësuar punën e Qendrës, por edhe për të vjelë kujtime për historinë e kësaj ngjarje, si edhe për vizitën në Qendër.

Pelegrinazhi në kujtim të gjenocidit "Bllacë 1999"

Pas krijimit të kësaj qendre përkujtimore, gjashtë ditët e para të prillit çdo vit duhet të jenë “pelegrinazhi "Bllacë 1999", që do të mbahet në kujtim të gjenocidit ndaj shqiptarëve dhe krizës së refugjatëve në Maqedoni. Të gjithë nxënësit, studentët dhe qytetarët e tjerë të Kosovës dhe shqiptarët e tjerë të Ballkanit dhe të mërgatës do të duhej që ato ditë ta vizitojnë Qendrën, të bëjnë

homazhe, të vendosin lule të freskëta dhe të kujtohen për ta freskuar memorien kolektive për atë histori të trishtë të shqiptarëve të Kosovës në kapërcyell të shekullit XX dhe XXI. Ajo qendër do të ishte simboli i vuajtjes së shqiptarëve në fund të shekullit XX.

Përveç ditëve të pelegrinazhit, secilin vit në këtë qendër mund të organizohen edhe aktivitete artistike, konferenca, koloni artistike, mbrenje poetike, shfaqje dramatike etj. Po ashtu secili burrështetas, që e viziton Kosovën, do të duhej ta vizitojë edhe atë qendër përkujtimore për ta ndërkombëtarizuar vuajtjen e shqiptarëve për paqe në Ballkan.

Për Maqedoninë, ky do të ishte një imazh i shkëlqyeshëm në sy të botës, sepse ka qenë pikërisht Maqedonia ajo që e ka ndihmuar Kosovën në ato çaste dhe që përsëri kjo qendër do të jetë e vendosur në territorin e Maqedonisë.

Një dimension tjetër i kësaj qendre do të ishte edhe aspekti komercial, sepse një pikë e tillë, që do të ishte me interes për gjithë botën shqiptare. Pos kësaj, meqë monumenti artistik do të ishte joshës edhe për turistët dhe vizitorët e rastit, kjo nënkupton edhe përfitime komerciale, që janë të njohura për qendra të tilla.

Propozim—përfundimi

Propozuesit e kësaj qendre përkujtimore, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta – Prishtinë u propozojnë dy qeverive përkatëse që në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive ta shqyrtojnë këtë propozim dhe atë ta vendosin në buxhetin e vitit të ardhshëm, duke caktuar koordinatörë të projektit nga të dyja palët. Përkritazi me këtë dy propozuesit janë në dispozicion të dy qeverive përkatëse që ta vënë në shërbimin e tyre gjithë kapacitetin shkencor dhe të gjitha resurset e tjera për realizimin e këtij projekti.

Detajet e tjera të menaxhimit të Qendrës Përkujtimore (statusi juridik, drejtoria, financat, shërbimet administrative, ciceronët, kus-tosët, hulumtuesit etj.) do të duhej të precizohen në marrëdhëniet ndërshtetërore.





Pamje nga manifestimi / treni muzeal “Bllaca 99”

Botues:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 25 – 2019

NATO, BLLACA DHE KOSOVA

Kryeredaktor: Dr. Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së
nr. 0201–09/2, të datës 14.01.2019, Shkup.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

313.1(497.115)"1999"

NATO, Bllaca, Kosova : (aktivitete me rastin e 20-vjetorit të intervenimit të NATO-s në Kosovë dhe eksodin e Bllacës) / [kryeredaktor Sevdail Demiri]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2019. - 100 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v. 25)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-4653-95-0

а) Етнички конфликти - Косово - 1999 - Собири
COBISS.MK-ID 110869514